

RAPORT PËR TË DREJTAT E NJERIUT NË MAQEDONI PËR VITIN 2016

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Republika e Maqedonisë është demokraci parlamentare. Presidenti i zgjedhur nga qytetarët është udhëheqës i shtetit dhe komandant suprem i forcave të armatosura. Parlamenti njëdhomësh ushtron pushtetin ligjvënës. Në muajin dhjetor u organizuan zgjedhjet presidenciale dhe presidenciale në vitin 2014. Në raportin preliminar për zgjedhje parlamentare të muajit dhjetor, Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë – Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (OSBE/ODIHR) ka deklaruar se ato kanë qenë transparente, të administruara mirë dhe të rregullta, por që janë zhvilluar "në rrethana të karakterizuara nga mungesa e besimit publik në institucione dhe te establishmenti politik" dhe se dështuan në përmbushjen e disa detyrimeve të rëndësishme të OSBE-së, për një proces demokratik zgjedhor. Problemet e konstatuara përfshijnë frikësimin e votuesve, presion i gjithanshëm mbi nëpunësit publik, blerje votash dhe shpërdorim të burimeve administrative.

Autoritetet civile kanë ruajtur kontrollin efektiv mbi forcat e sigurisë.

Vendi ka vazhduar të përjetojë një krizë politike të nxitur nga skandali me përgjimet në vitin 2015, kur partia e opozitës Lidhja Social Demokrate e Maqedonisë (LSDM) ka zbuluar se shërbimet sekrete qeveritare kanë përgjuar pa autorizim komunikimet, dhe publikisht ka lëshuar fragmente të këtyre komunikimeve me pretendimin se këto janë dëshmi të ndërhyrjeve politike në administratën publike dhe në media, si dhe të korrupsionit të nivelit të lartë. Falja e diskutueshme nga presidenti Gjorge Ivanov në prill për 56 individë në lidhje me skandalin e përgjimit shkaktoi protesta masive, që u quajtën "revolucioni i larmë," dhe vandalizmin e disa ndërtesave qeveritare dhe monumenteve. Presidenti Ivanov e tërhoqi faljen e tij më 6 qershor.

Problemet më të rëndësishme për të drejtat e njeriut kanë qenë rezultat i korrupsionit të vazhdueshëm dhe dështimit të qeverisë për të respektuar plotësisht sundimin e ligjit, përfshirë përpjekjet e vazhdueshme për të kufizuar lirinë e medias, ndërhyrjet në gjyqësi, dhe pengimin e punës së Zyrës së Prokurorisë Speciale e ngarkuar me hetimin dhe përndjekjen e krimeve lidhur me dhe që kanë rezultuar nga përgjimet e paligjshme si dhe administrimi selektiv i drejtësisë. Ndërhyrja politike, joefikasiteti, favorizimi i personave në pozita të mira, proceset e zvarritura, shkeljet e së drejtës për gjykim publik dhe korrupsioni e karakterizuan sistemin gjyqësor.

Probleme tjera të raportuara gjatë vitit kanë përfshirë: keqtrajtimin fizik të të ndaluarve dhe të burgosurve nga ana e policisë dhe rojeve të burgut; kushtet e këqija dhe mbipopullimi në disa burgje dhe institucione psikiatrike të vendit; qasje e vonuar nga ana e të burgosurve dhe të pandehurit në këshillim ligjor; kufizimi i mundësive për romët për t'u larguar nga vendi; kufizime të qasjes ndaj azilit; dhuna në familje ndaj grave dhe fëmijëve; diskriminimi ndaj personave me aftësi të kufizuara; diskriminimi institucional dhe shoqëror ndaj romëve dhe minoriteteve të tjera etnike dhe ndaj lezbikeve, gej, biseksualëve dhe personave trans-gjinor (LGBTI); dhe puna e fëmijëve, duke përfshirë lypjen e detyruar.

Qeveria ka ndërmarrë disa hapa të kufizuar për hetimin, përndjekjen dhe ndëshkimin e zyrtarëve policorë që janë fajtorë për përdorimin e forcës së tepërt, por mosndëshkimi edhe më tej ka vazhduar të mbetet si problem i rëndësishëm dhe i gjithanshëm.

Pjesa 1. Respektimi i integritetit të personit, duke e përfshirë edhe lirinë nga:

a. Privimi arbitrar ose i padrejtë nga jeta

Nuk ka pasur raporte që Qeveria ose përfaqësuesit e saj të kenë kryer vrasje arbitrare ose të paligjshme.

b. Zhdukje

Nuk ka pasur raporte zhdukjesh, rrëmbimesh ose kidnapimesh për motive politike.

c. Tortura dhe trajtimet ose ndëshkimet tjera mizore, çnjerëzore ose

poshtëruese.

Ligji i ndalon këto praktika, por ka pasur raporte sipas të cilave policia ka abuzuar me të ndaluarit dhe të burgosurit dhe ka ushtruar forcë të. Gjatë gjashtë muajve të parë të vitit, Sektori për Kontroll të Brendshëm dhe Standarde Profesionale (SSP) i Ministrisë së Punëve të Brendshme ka raportuar 38 ankesa të pranuar kundër efektivëve policorë, për ushtrim të forcës së tepërt. Ka ndërmarrë masa disiplinore kundër dy efektivëve policorë për këto vepra. Në nga janari deri në shtator vitin, Avokati i Popullit ka pranuar 96 ankesa kundër policisë për përdorim të paligjshëm ose të tepruar të forcës, 10 nga të cilat kanë qenë për torture dhe keqtrajtim gjatë ushtrimit të detyrës.

Në korrik, gjashtë nga 37 të dyshuarit të akuzuar për pjesëmarrje në përleshjet e armatosura me policinë në Kumanovë në maj të vitit 2015, ku u vranë 18 persona, kanë kërkuar ndihmë mjekësore nga gjykata, duke akuzuar policinë për brutalitet gjatë transportit të tyre nga objektet e paraburgimit në gjykatë. Avokatët e të dyshuarve kanë kërkuar shtyrje të pacaktuar të gjykimit, duke pretenduar se "tortura e të pandehurve është e evidente dhe kjo ka ndodhur që nga dita e parë e arrestimit të tyre deri në seancën e fundit." Gjykata ka informuar avokatët e të dyshuarve se raporti mjekësor ka konfirmuar abuzimin fizik të dy të pandehurve duke konstatuar lëndime të lehta. Më 20 korrik, ish-Ministri i Brendshëm Mitko Çavkov ka pretenduar se Ministria e Brendshme ka hetuar dhe ka testuar provat disa herë, duke konstatuar se nuk ka pasur fakte që mbështesin pretendimet e torturës. Në fund të vitit, asnjë polic nuk është akuzuar për torturë apo abuzim të të pandehurve, pavarësisht ankesave të përsëritura dhe thirrjeve për veprim nga ana e avokatit mbrojtës dhe Avokati i Popullit. Më 26 dhjetor, Ministria e Brendshme njoftoi se do të hetojë pretendimet e abuzimit dhe Prokuroria Publike e Shkupit ka konfirmuar se janë duke zhvilluar hetimin.

Gjatë gjashtë muajve të parë të vitit, gjyqësori ka vepruar në 22 raste që kanë të bëjnë me torturë, tetë nga të cilat kanë përfunduar me vendime gjyqësore – dhe më tej me masa të shërbimit të provës, që do të thotë se asnjë nga të dënuarit nuk ka vuajtur dënim me burg. Janë gjykuar 56 raste që kanë të bëjnë me ngacmime dhe keqtrajtime gjatë kryerjes së detyrës zyrtare, nga të cilat 17 kanë përfunduar me dënime - një me dënim me burg prej gjashtë muajsh dhe 16 dënime me kusht. Në Prokurorinë Themelore Publike janë dorëzuar 32 akuza për torturë gjatë kësaj periudhe, por janë hetuar dhe janë ngritur akuza në vetëm shtatë prej tyre. Në mënyrë të ngjashme, ajo ka marrë 138 ankesa për ngacmim dhe keqtrajtim gjatë kryerjes së detyrave zyrtare, ka hetuar 30 prej tyre dhe ka ngritur padi për 22 ankesa.

Kushtet e burgjeve dhe qendrave të paraburgimit

Burgjet dhe qendrat e paraburgimit në vend për të dyja gjinitë nuk i kanë përmbushur standardet ndërkombëtare. Mbipopullimin i lartë, dhe trajnimi joadekuat i gardianëve dhe personelit të burgjeve, mbeten problem të pranishme në të gjitha objektet.

Kushtet fizike: Vendi ka pasur 14 institucione ndëshkimore – 11 burgje dhe tre institucione edukuese-korrektuese për të mitur. Në shtatë nga burgjet janë vendosur edhe të paraburgosur në pritje të gjykimit. Burgjet ishin paraparë për vendosjen e 2.036 të burgosur, 43 të mitur dhe 450 persona në paraburgim. Më 3 tetor, sistemi penitenciar kishte gjithsej 3.346 individë - 3.034 të burgosur të rritur, duke përfshirë edhe gratë, 278 të paraburgosur dhe 25 të mitur.

Deri në muajin gusht, janë raportuar raste të vdekjeve në burgje dhe në objektet e paraburgimit. Është raportuar se të gjithë kishin vdekur nga shkaqe natyrore.

Sipas Zyrës së Avokatit të Popullit, kushtet e vështira kanë qenë shkak për rritjen e asaj që quhet "trajtimi çnjerëzor dhe degradues i të burgosurve dhe të paraburgosurve".

Raporti vjetor i Avokatit të Popullit ka konstatuar mbipopullim në institucionet korrektuese si problem kryesor që ka shkaktuar shumë sfida të tjera. Këto probleme dytësore përfshijnë kushte joadekuate të banimit për të burgosurit, kujdes të pamjaftueshëm dhe joadekuat shëndetësor, kushte të vështira dhe të përgjithshme të higjienës personale në institucionet, si dhe kushte sanitare të këqija. Personeli i pamjaftueshëm dhe trajtimi joadekuat i rojeve të burgut dhe personelit tjetër vazhdojnë të paraqesin problem në të gjitha objektet.

Administrimi: Autoritetet kanë konsideruar që mbajtja e evidencës në burgje është adekuate, por jo gjithmonë në kohën e duhur. Personat e burgosur dhe në paraburgim nuk kanë pasur mundësi të parashtrajnë ankesa pa frikë nga hakmarrja

Në përgjithësi, Avokati i Popullit ka konstatuar se hetimet e autoriteteve korrektuese mbi pretendimet për keqtrajtim dhe abuzimin e të burgosurve kanë qenë joefektive. Shumica e autorëve kanë vazhduar të abuzojnë pa u ndëshkuar dhe kur janë ngritur kallëzime penale, rastet nuk janë trajtuar menjëherë ose në mënyrë efikase. Që nga shtatori, Drejtoria për Ekzekutimin e Sanksioneve ka pranuar gjithsej 16 njoftime të përdorimit të forcës kundër të burgosurve nga policia e burgjeve. Në një rast, Drejtoria ka konstatuar se përdorimi i forcës ka qenë i pajustificuar. Avokati i Popullit gjithashtu hapi një hetim në një rast të një fëmije të dërguar në shtëpinë korrektuese për të mitur në Veles, i cili ishte dhunuar nga të burgosurit e tjerë, pas akuzave se autoritetet korrektuese nuk e kanë raportuar rastin dhe u përpoqën ta fshihnin.

Vëzhgimi i pavarur: Ligji mundëson që personat në paraburgim të vizitohen nga mjekët, përfaqësuesit diplomatikë dhe përfaqësuesit e Këshillit të Komisionit të Evropës për Parandalimin e Torturës dhe të Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq, me leje paraprake nga gjykatësi hetues. Qeveria zakonisht ua ka lejuar organizatave të pavarura humanitare, siç është Komiteti i Helsinkit në vend, qasjen deri te të burgosurit e dënuar me kërkesë të të burgosurve.

Avokati i Popullit i ka vizituar rregullisht burgjet e vendit dhe i ka hetuar të gjitha pretendimet e besueshme të kushteve problematike, edhe pse në shumë raste stafi i Avokatit të Popullit është larguar për shkak se administratorët e burgut ishin me pushime ose në pushim mjekësor.

a. Arrestimi ose paraburgimi arbitrar

Edhe pse ligji e ndalon arrestimin ose paraburgimin arbitrar, Qeveria nganjëherë nuk i ka respektuar këto ndalesa. Statistikat e Qeverisë kanë treguar se prokurorët kanë kërkuar urdhër paraburgimi në rreth 5 për qind të të gjitha rasteve. Edhe pse brenda kufijve të ligjit, paraburgimi është aplikuar në mënyrë selektive për të mbështetur qëllimet dhe pozicionet politike të Qeverisë. Aktivistët e të drejtave civile kanë deklaruar se gjykatat kanë aprovuar pothuajse të gjitha kërkesat e paraburgimit nga Prokuroria Publike Themelore për raste të profilit të lartë ku janë përfshirë kundërshtarë të Qeverisë, duke pretenduar se kjo është bërë nën ndikimin e Qeverisë, por shpesh duke mos ofruar arsyetime adekuate siç kërkohet nga ligji.

Ka pasur shembuj evidentë të arrestimeve dhe ndalimeve selektive gjatë protestave të "Revolucionit të larmë", që filluan si përgjigje ndaj vendimit për falje nga Presidenti Ivanov më 12 prill. Në fillim të protestave, policia arrestoi pjesëmarrësit për akte vandalizmi dhe lëndim të efektivëve të policisë. Ndërsa në kundër-protestat në qytetin e Manastirit nga përkrahësit e Lëvizjes pro-qeveritare qytetare për Mbrojtjen e Maqedonisë (GDOM) ndodhën akte të ngjashme të vandalizmit dhe lëndime të policisë, nuk ka pasur raporte për arrestime.

Më 13 prill, policia ka lënduar disa persona gjatë arrestimit të 13 studentëve mbështetës të "Revolucionit të larmë". Studentët e arrestuar janë dërguar në stacionet policore, Janë përballur me shtyrje të paraqitjes para prokurorit dhe gjyqtarit, dhe iu është mohuar ndihma mjekësore dhe qasja deri te avokatët për 12 orë përtej maksimumit ligjor 12-orësh. Policia i ka akuzuar ata për "pjesëmarrje në turmë për kryerje të veprës penale" për shkatërrim të zyrës publike të Presidentit në qendër të Shkupit, duke thyer dritaret, duke dëmtuar veprat e artit, duke ia vënë zjarrin dhe duke thyer mbyllet e zyrës. Nga 13 personat e arrestuar, padi penale është ngritur kundër tre personave, ndërsa 10 prej tyre janë përballur me dënime për kundërvajtje. Tre të parët mbetën në arrest shtëpiak, ndërsa gjykimet e tyre janë shtyrë disa herë për shkak të mosparaqitjes së akuzave specifike nga Qeveria. Në fund të muajit maj, të tre u deklaruan fajtor për shkakimin e dëmit prej rreth 522.000 denarë (\$ 9,030) dhe morën dënime me kusht.

Pjesëmarrësit në kundër-protestat e lëvizjes GDOM kanë dëmtuar pronën publike në Manastir dhe kanë sulmuar gazetarë dhe policë. Asnjë anëtarë i lëvizjes GDOM, megjithatë, nuk është arrestuar. Në Manastir, anëtari i Këshillit komunal nga partia opozitare LSDM, Bllagojçe

Kotevski ka kritikuar raportin e shtatorit për rendin publik, duke thënë se në të ishin cituar dëmtime nga mbështetësit e "Revolucionit të larmë", por jo nga lëvizja GDOM. Kotevski ka kritikuar policinë për mos reagimin ndaj mbështetësve të GDOM që kishin dëmtuar selinë e LSDM-së dhe reklamat e partisë gjatë protestave. Ai gjithashtu ka vënë në dukje se Dushko Ilievski, një mbështetës i Revolucionit të larmë, është arrestuar për lëndimin e një efektiv të policisë, por nuk u ndërmor asnjë veprim i ngjashëm kundër anëtarëve të lëvizjes GDOM kur një efektiv i policisë është lënduar gjatë një proteste të lëvizjes GDOM.

Aktivistët kanë pohuar se Qeveria në mënyrë selektive ka arrestuar anëtarë të organizatave të shoqërisë civile për t'i frikësuar dhe për të dekurajuar pjesëmarrjen e tyre në protesta. Në muajin qershor, autoritetet e arrestuan dy herë Pavle Bogoevskin, një ish anëtar i organizatës së shoqërisë civile Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Republikën e Maqedonisë, për pjesëmarrje në aktivitetet e Revolucionit të larmë. Bogoevski u arrestua për herë të parë më 19 qershor sepse ishte përpjekur të shfaqë një afishe me kritikë kundër Qeverisë, në afërsi të vendit ku partia në pushtet, VMRO-DPMNE, po e festonte përvjetorin e saj. Më 27 qershor, ai është arrestuar sërish pas një proteste me pretendimin se nuk e kishte paraqitur kartën e tij të identifikimit. Bogoevski është liruar menjëherë pas çdo arrestimit dhe më vonë është akuzuar për "pjesëmarrje në turmë për kryerje të veprës penale", për hedhje të bojës mbi godinën e Ministrisë së Kulturës më 18 prill. Gjykimi i Bogoevskit është shtyrë tre herë që nga fillimi i tij më 4 tetor. Fillimisht, është shtyrë për shkak se Prokuroria Themelore Publike nuk e ka përcaktuar shumën e saktë të dëmeve në ndërtesën e Ministrisë së Kulturës. Avokati i Bogoevskit kërkoi shtyrjen e dytë më 14 nëntor, pasi iu paraqit një vlerësim i dëmit në shumë prej 378000-denarë (6540 \$), përgatitur nga ekspertët në Institutin e Forenzikës Ligjore. Gjykimi është caktuar të fillojë më 21 dhjetor, por është shtyrë për 30 janar 2017.

Roli i policisë dhe aparatit të sigurisë

Ushtria është përgjegjëse për sigurinë e jashtme dhe i raporton Ministrisë së Mbrojtjes. Policia kombëtare ruan sigurinë e brendshme, duke përfshirë edhe migracionin dhe mbrojtjen e kufijve, dhe përgjigjet para Ministrisë së Punëve të Brendshme. Autoritetet civile nuk i kanë tejkuluar mangësitë në mbikëqyrjen e efektivëve të policisë, në veçanti të njësisë për kundërzbulim në Ministrinë e brendshme, e cila, pa autorizim ligjorë ka përgjuar mbi 20000 individë gjatë një periudhe shumëvjeçare (shih pjesën 1.f.). Në Ministrinë e Brendshme dhe në Zyrën e Avokatit të Popullit ka arritur një numër i madh i ankesave për përdorim tejmase të forcës gjatë ushtrimit të detyrave zyrtare (shih pjesën 1.c.). Megjithatë, gjatë vitit ka pasur raporte për mosndëshkim që përfshijnë forcat e policisë. Vëzhguesit ndërkombëtarë, ambasadat dhe OJQ-të lokale e kanë cekur korrupsionin, mungesën e transparencës dhe presionin politik në Ministrinë e Punëve të Brendshme si pengesë për luftimin e krimit, në veçanti krimit të organizuar.

Përveç hetimit të pretendimeve për keqtrajtim policor, Sektori për Standarde Profesionale (SSP) i Ministrisë së Brendshme ka realizuar të gjitha hetimet e brendshme mbi pretendimet për forma tjera të sjelljes së keqe të policëve. Sektori, gjatë hetimeve, ka të drejtën e shqiptimit të sanksioneve administrative, siç është suspendimi i përkohshëm nga puna, por nuk mund të ndërmer masa disiplinore që kërkojnë vendim nga komisioni disiplinor ose sanksione më serioze penale për të cilat nevojitet vendimi i gjyqit. Gjatë gjysmës së parë të vitit, njësia ka nisur nisi masa disiplinore ndaj 110 efektivëve të policisë dhe ka ngritur 10 padi penale kundër punonjësve të Ministrisë së Brendshme për vepra penale, duke përfshirë edhe "shpërdorim të pozitës zyrtare", "mashtrim", dhe "keqtrajtim më kryerjen e detyrës. "

Procedurat e arrestimit dhe trajtimi i të ndaluarve

Kodi i Procedurës Penale parasheh që gjyqtari të lëshojë urdhër për arrestimin dhe ndalimin të të dyshuarve bazuar në prova, dhe policia në përgjithësi ka ndjekur këtë dispozitë. Ligji parasheh që personi i ndaluar të paraqitet para prokurorit në afat prej 24 orëve pas arrestimit. Gjyqtari i procedurës paragjyqësore, me kërkesë të prokurorit mund të urdhërojë ndalimin e të dyshuarit deri në 72 orë para daljes në gjyq. Në përgjithësi, policia u është përmbajtur këtyre procedurave. Autoritetet në përgjithësi kanë informuar të ndaluarit menjëherë për akuzat kundër tyre. Paraburgimi para ngritjes së padisë mund të zgjasë më së shumti 180 ditë. Pas ngritjes së padisë, periudha maksimale e paraburgimit është dy vite.

Në shumicën e rasteve, gjykata ka respektuar ligjin për procedurat e paraburgimit paragjyqësor. Problematike kanë qenë selektiviteti dhe mungesa e transparencës së gjykatave gjatë vlerësimit të kërkesave për paraburgim para apo gjatë gjykimit. Sipas burimeve të gjykatës, prej 2012 deri 2016, Gjkata Themelore Shkup I, gjykata kryesore penale e vendit, ka pranuar 99 për qind të kërkesave për paraburgim të paraqitura nga Zyra e Prokurorisë për Krim të Organizuar dhe Korrupsion. Në të njëjtën kohë, gjykatat kanë refuzuar shumicën e kërkesave të ngjashme për paraburgim dhe masave të tjera parandaluese të paraqitura nga Prokuroria Speciale. Janë aprovuar vetëm katër nga 23 kërkesat për paraburgim nga Zyra e Prokurorisë Speciale. Një nga këto kërkesa u refuzua pas faljeve të diskutueshme të presidentit Ivanov më 12 prill, ndërsa tre të tjerat u ndryshuan në arrest shtëpiak, dy prej të cilave nuk u zgjatën, ndërsa e treta u zgjat dhe më vonë u shfuqizuar në Apel. Gjkatat gjithashtu kanë refuzuar 18 kërkesa nga Zyra e Prokurorisë Speciale për masat parandaluese, duke përfshirë arrestin shtëpiak dhe konfiskimin e pasaportës. Përveç kësaj, gjykatat shpesh nuk kanë arritur të japin arsyetim të përshtatshëm për zgjatjen, zëvendësimin, ose ndërprerjen e paraburgimit.

Sistemi i dorëzimit është në fuqi. Ligji i lejon të pandehurit të komunikojë me një avokat të zgjedhur prej tyre, por autoritetet nuk kanë informuar gjithmonë të ndaluarit ashtu siç duhet për të drejtën e tyre dhe nuk kanë lejuar gjithmonë që të konsultohen me një avokat para paraqitjes në gjykatë. Të ndaluarit e varfër kanë të drejtë të kenë avokat në llogari të shtetit, dhe autoritetet në përgjithësi e kanë respektuar këtë kërkesë. Gjyqtarët zakonisht u kanë dhënë leje avokatëve për të vizituar klientët e tyre në paraburgim. Ka pasur raporte sipas të cilave policia ka vazhduar t'i thërrasë të dyshuarit dhe dëshmitarët në stacione policore për "biseda informative" pa i informuar për të drejtat e tyre dhe pa praninë avokatit. Vendi nuk e ka praktikuar paraburgimin pa njoftim. Në disa raste, autoritetet i kanë mbajtur të dyshuarit në arrest shtëpiak.

Në mes të muajit prill dhe korrik, disa pjesëmarrës kryesorë të protestave të mëdha anti-qeveritare janë akuzuar për "pjesëmarrje në turmë që kryen veprë penale." Edhe pse, në përputhje me ligjin, procedura e paraburgimit të tyre ishte përcaktuar për pesë ditë, megjithatë, paraburgimi ka vazhduar me një bllok prej 30-ditësh për disa të dyshuar të këtij rasti. Për shembull, Zdravko Saveski dhe Vladimir Kunovski i partisë politike Levica ("Left") janë arrestuar më 25 prill pasi janë thirrur në stacionin policor Prolet për t'u marrë në pyetje. Saveski dhe Kunovski pas gati dy muaj arrest shtëpiak janë liruar më 10 qershor. Sipas prokurorëve, Saveski dhe Kunovski janë fotografuar me video duke vandalizuar zyrën publike të Presidentit Ivanov në qendër të Shkupit më 13 prill. Si rrjedhojë ata u vendosën në arrest shtëpiak. Gjkata ka pranuar propozimin e avokatëve mbrojtës për të hequr arrestin e tyre shtëpiak më 10 qershor dhe kanë urdhëruar Saveskin dhe Kunovskin të dorëzojnë pasaportat e tyre si masa parandaluese për të parandaluar rrezikun e arratisjes. Më 6 korrik, gjykata ua ktheu pasaportat Saveskit dhe Kunovskit, por dy muaj më vonë, Ministria e Brendshme e ka penguar Saveskin të udhëtojë jashtë vendit, duke pretenduar se Ministria nuk ka marrë njoftimin zyrtar të gjykatës për heqjen ndalimit. Gjkata fillimisht ka caktuar gjykimin e tyre për 15 shtator, por gjykimi është shtyrë disa herë për shkak se gjyqtari nuk e kishte marrë shumën e saktë të dëmeve që ata e kanë shkaktuar në zyrën e Presidentit. Gjykimet e tyre kanë qenë të papërfunduar deri në fund të vitit.

Mundësia e të ndaluarve të kundërshtojnë ligjshmërinë e paraburgimit para gjykatës:Të dyshuarit e arrestuar, avokatët e tyre ose anëtarët e familjes së ngushtë mund t'i parashtrojnë kërkesë gjykatës për të vendosur mbi ligjshmërinë e paraburgimit ose të lirohen me urdhër gjyqësor, si dhe të marrin kompensim për personat e ndaluar në mënyrë të paligjshme

e. Mohimi i gjykimit të drejtë publik

Kushtetuta parashikon gjykata "autonome dhe të pavarura", të mbështetura nga Këshilli Gjyqësor i pavarur dhe autonom. Gjyqësori nuk ia doli të demonstrojë pavarësinë dhe paanshmërinë e vet, ndërsa gjyqtarët iu nënshtruan ndikimit politik dhe korrupsionit. Rezultatet e shumë veprimeve gjyqësore janë treguar si të paracaktuara, veçanërisht në rastet kur të pandehurit kanë pasur pikëpamje ose kanë ndërmarrë veprime në kundërshtim me Qeverinë. Financimi joadekuat i gjyqësorit ka vazhduar ta pengojë punën dhe efektivitetin e gjykatave. Disa zyrtarë gjyqësorë e kanë akuzuar Qeverinë për shfrytëzimin e fuqisë buxhetore për të ushtruar kontroll mbi gjyqësorin.

Sipas Raportit të Avokatit të Popullit për vitin 2015, vendin e dytë sipas numrit të ankesave të parashtruara nga qytetarët (19,3 i totalit) deri te Avokati i Popullit kanë qenë në lidhje me gjyqësorin. Raporti ka cekur se qytetarët janë ankuar në lidhje me gjykimet e gjata, paanshmërinë, drejtësinë selektive, dhe presion i tepërt mbi gjyqtarët. Një shumë e konsiderueshme e buxhetit të gjyqësorit është shpenzuar për dëmshpërblimet për shkeljen e të drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm. Raporti thekson se vendimet gjyqësore nganjëherë janë vonuar në mënyrë të konsiderueshme për shkak të mangësive administrative ose për shkak se gjyqtarët kanë tejkaluar afatet e përcaktuara me ligj për dhënien e vendimeve gjyqësore me shkrim. Hetimet paraprake nga Zyra e Avokatit të Popullit kanë treguar se situata është përkeqësuar gjatë vitit.

Në një raport të lëshuar në muajin qershor të vitit 2015, Grupi i Lartë i Ekspertëve i Komisionit Evropian ka deklaruar se, "disa burime" kanë raportuar se "ekziston një atmosferë e presionit dhe pasigurisë brenda gjyqësorit. Shumë gjyqtarë besojnë se avancimi në radhët e gjyqësorit është rezervuar për ata që me vendimet e tyre favorizojnë establishmentin politik". Raporti, gjithashtu, vuri në dukje se, edhe pse ka pasur rregulla të rrepta që e rregullojnë shpërndarjen e lëndëve, të realizuara nëpërmjet një sistemi elektronik të menaxhimit të çështjeve, ka pasur një perceptim se rregullat nuk janë respektuar gjithmonë dhe se janë gjetur mënyra për të anashkaluar sistemin elektronik. Në Raportin vjetor të progresit, Komisioni Evropian vuri në dukje akuzat për ndërhyrje të drejtpërdrejtë nga autoritetet gjyqësore në përdorimin e sistemit informatikë të menaxhimit të rasteve për të caktuar gjyqtarë për t'u marrë me procedura specifike të iniciuara nga Prokuroria Speciale.

Në një shembull të politizimit të emërimeve gjyqësore, në fillim të shtatorit Këshilli Gjyqësor ka zgjedhur 28 gjyqtarë të rinj, shumë prej të cilëve janë parë, si ithtarë të partisë në pushtet, VMRO-DPMNE për të shërbyer në Gjykatën Supreme, Gjykatën Administrative, Gjykatat e Apelit në Shkup, Manastir dhe Shtip, dhe disa gjykata themelore, duke përfshirë dy gjykatat më të mëdha penale dhe civile në Shkup. Ekspertët ligjorë dhe analistët kanë pohuar se ithtarët e VMRO-DPMNE-së kanë dominuar Këshillin Gjyqësor dhe se partia ka ndikuar politikisht në emërimet. Ekspertët kanë deklaruar se emërimi i ithtarëve të partisë në pushtet shumë afër zgjedhjeve të parakohshme parlamentare kanë shërbyer edhe për të rritur mbështetjen elektorale dhe për t'i rregulluar gjykatat në rast se Prokuroria Speciale ngre akuza kundër anëtarëve të partisë. Sindikata e nëpunësve gjyqësor dhe administratës gjithashtu kanë thënë se në mesin e atyre që janë avancuar nga Këshilli Gjyqësor kanë qenë gjyqtarët që kanë kërcënuar anëtarë të sindikatave gjatë kryerjes së grevës së punonjësve në maj-korrik, me gjoba disiplinore ose pushim nga puna. Sipas sindikatës, ky korrelacion ka krijuar perceptimin se avancimet e gjyqtarëve ishin shpërblime për shërbimin e tyre gjatë grevës.

Gjatë vitit, një numër i gjyqtarëve ka shprehur publikisht shqetësimin se manipulimi politik i emërimeve gjyqësore ishte bërë evident, sidomos në rastet nga Zyra e Prokurorisë Speciale. Në fund të prillit, kryetari i Gjykatës Themelore Shkup I, gjyqtari Vlladimir Pançevski ka emëruar dy gjyqtarë të rinj në departamentin e Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit në Gjykatë, gjë që shumë analistë politikë dhe ligjorë e kanë përshkruar si rrethana të dyshimta, pasi asnjë prej tyre nuk kishte përvojë të mjaftueshme gjyqësore për të justifikuar emërimin e tyre. Të dy këta gjyqtarë janë caktuar në rastet e paraqitura nga Prokuroria Speciale, e cila pa sukses ka kërkuar përjashtimin e tyre nga rastet për shkak të konfliktit të perceptuar të interesit (shih Pjesën 4).

Komunikimet e përgjuara të lëshuara nga partia opozitare e LSDM-së në shkurt të vitit 2015 tregonin ndikim të papërshtatshëm mbi gjyqësorin nga dega ekzekutive (shih pjesën 1.f.). Bisedat e shumta të regjistruara kishin të bëjnë me përfaqësues të degës ekzekutive që ndikojnë në procesin e emërimit të gjyqësorit, ndërsa gjyqtarët i marrin pozitën e tyre me anë të ryshfetit. Për shembull, gjyqtarja Lidija Tupançevska Petrovska, njëra nga dy gjyqtarët e caktuar është përmendur në aktakuzat e para të paraqitura nga Zyra e Prokurorisë Speciale në një nga bisedat e përgjuara në mënyrë të paligjshme ku pretendohet se ka blerë emërimin e saj si gjyqtare duke blerë bizhuteri të shtrenjta për kryetaren e Gjykatës Supreme Lidija Nedellkova.

Në Raportin e muajit qershor të vitit 2015 të Grupit të Ekspertëve të Lartë të Komisionit Evropian janë ngritur shqetësime në lidhje me drejtësinë e dënimit të Zvonko Kostovskit, i pandehur në rastin e ashtuquajtur "grusht-shteti". Kostovski, një oficer i kundërzbulimit në Ministrinë e Brendshme, është shpallur fajtor për spiunazh dhe përgjim të paligjshëm të komunikimeve dhe është dënuar me tre vjet burg. Kostovski ka pohuar se ai kishte bërë

përgjime të bisedave kompromituese për kreun e partisë opozitare LSDM-së Zoran Zaev në mënyrë që ai të shantazhojë ish kryeministrin Nikolla Gruevski dhe ta detyrojë atë që ta fuste LSDM-në në Qeveri. Në raportin e tij, Grupi i Lartë i Ekspertëve ka shprehur shqetësimin se ka qenë e pamundur të dihet se në çfarë mase faktet kanë mbështetur pranimin e fajësisë dhe nëse dënimi i lehtë ka qenë një shpërblim për pjesëmarrje në fshehjen e përfshirjes së të tjerëve. Në tetor, Prokuroria Speciale ka kërkuar një rishikim të jashtëzakonshëm nga ana e Gjykatës Supreme në lidhje me ujdinë e Kostovskit. Vendimi i Gjykatës së Lartë është në rrjedhë e sipër deri në fund të vitit.

Procedurat gjyqësore

Kushtetuta dhe ligji parashikojnë të drejtën për një gjykim të drejtë, edhe pse ndërhyrjet politike në punën dhe emërimin e gjyqësorit shpesh e kanë shkelur këtë të drejtë.

Në korrik 2015, një ligj i ri hyri në fuqi i cili përmban udhëzime të përditësuara të dënimeve të projektuara për të trajtuar dënime në kundërshtim me gjykata të niveleve të ndryshme. Gjatë vitit, analistët ligjorë janë shprehur të shqetësuar se ligji i ri pengon seriozisht diskrecionin gjyqësor për të vendosur dënime në bazë të fakteve në rastet individuale, ndërkaq prokurorëve u ka dhënë shumë fuqi për të ndikuar në dënimin.

Ligji e parasheh prezumimin e pafajësisë, deri në momentin kur dëshmohet fajësia e të pandehurve. Të pandehurit kanë të drejtë të informohen menjëherë dhe hollësisht për akuzat (me interpretim falas sipas nevojës), por autoritetet nuk e kanë respektuar gjithmonë këtë të drejtë. Në përgjithësi, gjykimet kanë qenë të hapura për publikun, ndonëse me vonesa serioze dhe të shpeshta.

Ligji ua mundëson të pandehurve dhe avokatëve të tyre qasjen në provat që i kanë autoritetet. Në disa raste, megjithatë, avokatët pretenduan se ata nuk i kanë marrë provat nga prokuroria në kohën e duhur, e që i ka penguar në mbrojtjen e klientëve të tyre. Avokati i disa nga të pandehurve në rastin e Kumanovës, një rast shumë aktual dhe kontrovers në lidhje me shkëmbimin e zjarrit në maj të vitit 2015, me ç'rast jetën e humbën 10 njerëz të armatosur dhe 8 policë, publikisht u ankua se nuk i është mundësuar qasje deri te provat kritike të cilat i posedon prokuroria.

Avokatët mbrojtës dhe aktivistë të të drejtave të njeriut kanë pretenduar se mbyllja e disa gjykimeve të profilit të lartë për publikun për të mbrojtur konfidencialitetin e disa dëshmitarëve dhe provave të marra përmes përgjigjeve me urdhër gjykate e kanë zvogëluar transparencën dhe kanë kontribuar në zvogëlimin e besimit të publikut në gjykata, veçanërisht në mesin e popullatës shqiptare. Mbrojtja në gjykimin e Kumanovës, pjesa më e madhe e të cilit u mbajt me dyer të mbyllura, në mënyrë të përsëritur ka ngritur shqetësime të tilla.

Për disa raste penale dhe civile, janë përdorur panele gjyqësore prej tre deri pesë individë, të udhëhequr nga një gjyqtar profesionist. Autoritetet nuk i kanë dhënë gjithmonë të pandehurit kohë dhe mundësi të mjaftueshme për të përgatitur mbrojtje. Të pandehurit mund t'u bëjnë pyetje dëshmitarëve dhe të paraqesin prova në emër të vet. Autoritetet nuk mund të detyrojnë të pandehurit të dëshmojnë ose të pranojnë fajësinë. Si prokuroria ashtu dhe të pandehurit kanë të drejtën të parashtojnë ankesa ndaj aktgjykimeve.

Të burgosurit dhe të arrestuarit politikë

Gjatë vitit, ka pasur pretendime se Qeveria ka ndjekur dhe ka burgosur persona për arsye politike.

Më 12 prill, autoritetet serbe arrestuan gazetarin kontrovers Zoran Bozhinovski dhe miratuan ekstradimin e tij në Maqedoni në bazë të një urdhër-arresti të Interpolit duke e akuzuar atë për organizim kriminal, spiunazh, dhe grabitje. Si dhe se ai ka qenë pjesë e një rrjeti spiunazhi që ka punuar për një qeveri të huaj. Bozhinovski thuhet se ishte zhvendosur në Serbi për shkak të shqetësimit për sigurinë e tij, pas postimit të artikujve me kritika ndaj Qeverisë, VMRO-DPMNE-së partia në pushtet, dhe ish-kryeministrin Nikolla Gruevski. Në vitin 2013 autoritetet serbe e arrestuan dhe më pas e liruan atë.

Më 18 korrik, prokurori publik për Krime të Organizuara dhe Korrupsion ngriti një padi të re kundër Bozhinovskit. Gjykimi i tij më pas u shty pasi kryetari i trupit gjykues kërkoi të zëvendësohet. Më 14 shtator, Bozhinovski filloi një grevë urie, duke refuzuar ushqim dhe ujë; është raportuar se ka marrë trajtime intravenoze dy herë në ditë. Mbrojtësi i Bozhinovskit dhe Avokati i Popullit kanë deklaruar se nuk ishin njoftuar në lidhje me grevën e urisë deri më 22 shtator. Mbrojtja e tij ka raportuar se ai protestonte për shtyrjen gjashtëmujore të gjykimit të tij dhe se ka qenë i përgatitur të vdes në burg. Më 28 shtator, Bozhinovski i ka vënë fund grevës së urisë, kur gjykata ka shpallur se gjykimi i tij do të vazhdojë më 19 tetor. Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë (SHGM) dhe Federata Evropiane e Gazetarëve ka bërë thirrje për lirimin e tij. Gjykimi i Bozhinovskit filloi më 10 nëntor, ndërkaq në fund të vitit ishte në zhvillim e sipër.

Në nëntor gjykata ka pezulluar për kohë të pacaktuar rastin e ashtuquajtur "grusht shteti", i cili ka dalë si rrjedhojë e bisedave të përgjuara në mënyrë të paautorizuar nga shërbimet e inteligjencës së Qeverisë prej 2008 deri 2015. Gjyqtarja Lubinka Bashevka, kryesuese e trupit gjykues pesë anëtarësh në mbikëqyrje të gjykimit ka dhënë si arsye mos sigurimin e certifikatave të detyrueshme të sigurisë për dy anëtarë të porotës së sapoemëruar. Në këtë rast, lideri i opozitës Zoran Zaev dhe katër të pandehur të tjerë janë akuzuar për spiunazh dhe dhunë ndaj zyrtarëve të shtetit në lidhje me skandalin e përgjimit të paligjshëm. Gjykimi është shtyrë disa herë, duke përfshirë edhe rastin kur gjykata ka vendosur të mos thërrasë ish-kryeministrin dhe liderin aktual e partisë VMRO-DPMNE Nikolla Gruevski në gjykim, pavarësisht nga fakti se ai ishte dëshmitar i vetëm kundër Zaevit.

Procedurat dhe mjetet juridike civile

Qytetarët kanë pasur qasje në gjykata për ngritjen e procedurave me të cilat kërkohet dëmshpërblim për shkeljen e të drejtave të njeriut. Individët mund të iniciojnë procedura për të drejtat e njeriut në gjykatat civile, penale ose administrative, dhe në jukatën Kushtetuese, varësisht nga lloji i shkeljes së të drejtave të njeriut dhe nga subjekti që ka bërë shkeljen e pretenduar. Individët mund të parashtrojnë edhe ankesa ndaj aktgjykimeve të pavolitshme. Ligji e parasheh të drejtën e gjykimit brenda afatit të arsyeshëm dhe kjo është bazë ligjore për ngritjen e procedurave kundër vonesave të tepërta para Gjykatës Supreme. Në përgjithësi, Qeveria i ka respektuar aktgjykimet civile të gjykatave vendase. Individët mund të ankohen për rastet që përfshijnë shkeljet e pretenduara nga shteti të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut në Strasburg, pasi të jenë shterur të gjitha mundësitë e brendshme ligjore.

Raporti vjetor i Avokatit të Popullit për vitin 2015, vuri në dukje problemet e vazhdueshme në lidhje me të drejtën e gjykimit në një kohë të arsyeshme. Sipas raportit, raste të zvarritura gjyqësore civile dhe administrative, si dhe praktikat e pamjaftueshme të zbatimit civil, kanë rezultuar me shkelje të të drejtave të qytetarëve.

f. Ndërhyrje arbitrare në privatësi, familje, shtëpi ose korrespondencë

Ligji i ndalon këto veprime, megjithëse ka raporte që tregojnë se Qeveria nuk i ka respektuar këto ndalime gjatë vitit.

Qeveria ka vazhduar të merret me pasojat e zbulimit të përgjimeve të paligjshme, për të cilat pretendohet se janë kryer vite të tëra brenda ambienteve të Drejtorisë për Siguri dhe Kundërzbulim, që u raportua për herë të parë nga LSDM-ja opozitare në shkurt të vitit 2015. Në raportin e qershorit 2015, Grupi i Ekspertëve të Lartë të Komisionit Evropian e ka përshkruar si "shqetësues" dështimin e Drejtorisë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Agjencisë përgjegjëse për Mbikëqyrjen e Trajtimit të të Dhënave Personale nga Qeveria, që të angazhohen në mënyrë më aktive në hetimin e skandalit të përgjimeve të paligjshme. Në mënyrë të veçantë, grupi ka kritikuar mosveprimin e Drejtorisë ndaj "mungesës evidente të mbrojtjes së të dhënave, regjistrimit të mundshëm e të palejueshëm dhe të pakontrolluar të numrave të telefonit, si dhe privimin e të drejtës së privatësisë nëpërmjet ndjekjes së paautorizuar."

Në maj koalicioni qeveritar, nëpërmjet një procedure të përshpejtuar, ka miratuar ndryshimet në Ligjin për mbrojtjen e privatësisë të cilat e ndalojnë posedimin, përpunimin dhe publikimin e çdo përmbajtje, duke përfshirë bisedat e përgjuara, me ç'rast shkelet e drejta e privatësisë në

lidhje me jetën personale apo familjare. Amendamentet, e planifikuara që të hyjnë në fuqi në korrik të vitit 2017, gjithashtu e ndalojnë përdorimin e materialeve të tilla në fushatat zgjedhore apo për qëllime të tjera politike.

Lustrimi – procesi i identifikimit publik të individëve të cilët kanë bashkëpunuar me shërbimet e fshehta gjatë periudhës së komunizmit, si dhe ndalimit të tyre nga ushtrimi i detyrave zyrtare dhe përfitimeve tjera qeveritare – mbeti si pike e përplasjes politike. Në gusht 2015, Parlamenti miratoi ligjin për ndërprerjen e lustrimit dhe pamundësimin që Komisioni i Lustrimit të hapë raste të reja pas gushtit 2015. Ligji i ka dhënë Komisionit afat prej një viti për të punuar në raste të cilat tanimë ishin hapur.

Një rast i njohur i lustrimit ka përfshirë Trendafil Ivanovskin, ish-kryetar i Gjykatës Kushtetuese dhe personi i parë që iu nënshtrua procedurës së lustracionit. Në janar, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut vendosi se në procedurën e lustrimit kundër Ivanovskit është shkelur e drejta e respektimit të jetës private dhe familjare sipas Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Si pjesë e vendimit, shteti ka qenë i detyruar të paguajë dëmshpërblim Ivanovskit prej 5350 euro. Deri në fund të vitit, Gjykata Administrative ka anuluar të paktën 40 vendime të lustracionit për shkelje të gjykimit të drejtë, duke hapur mundësinë për personat e prekur për të kërkuar dëmshpërblim nga shteti.

Pjesa 2. Respektimi i lirive civile, ku përfshihet:

a. Liria e fjalës dhe shtypit

Kushtetuta e garanton lirinë e fjalës dhe shtypit, por presioni qeveritar mbi mediet ka vazhduar të paraqes një problem. Ka pasur akuza të shumta gjatë vitit që Qeveria ka përndjekur në mënyrë selektive përfaqësues të opozitës dhe ka ndërhyrë në raste të shpifjes të iniciuara nga zyrtarë të lartë të Qeverisë. Organizata Ndërkombëtare e Monitorimit të Mediave - Reporter pa Kufij (Reporters without Borders) ka vërejtur rënie në lirinë e medias gjatë vitit, veçanërisht në lidhje me shpërndarjen e fondeve qeveritare për reklama shtetërore për të ushtruar kontroll mbi mediat. Organizata ndërkombëtare e të drejtave të njeriut Freedom House, gjithashtu ka dhënë vërejtje të njëjta, duke i karakterizuar mediat si “jo të lira”.

Shumë anëtarë të komunitetit të medias, duke përfshirë Shoqatën e Gazetarëve në Maqedoni (ShGM), shpesh kanë akuzuar Qeverinë se ka dështuar të respektojë lirinë e fjalës dhe të shtypit. Në një sërë raportesh të monitorimit të medias në fillim të vitit, programi i Institutit për Studime të Komunikimit, Macedonian Democracy Watch ka deklaruar se katër nga pesë shtëpitë kombëtare televizive (Sitel, Kanal 5, Alfa, dhe MTV 1) kanë sinkronizuar raportime në favor të VMRO-DPMNE-së. Ata e kanë bërë këtë duke theksuar në raportimet e tyre projekte dhe arritje të partisë dhe duke mbështetur sulmet e partisë kundër Prokurorisë Speciale. Raportet e monitorimit gjithashtu kanë vënë në dukje një incidencë të lartë të rasteve të konvergencës editoriale midis katër kanaleve televizive, duke pretenduar se kjo vë në dukje një koordinim të mesazheve në mbështetje të agjendës së partisë në pushtet.

Liria e fjalës dhe shprehjes: Ligji e ndalon gjuhën e cila nxit urrejtje nacionale, fetare ose etnike dhe parasheh sanksione për personat që i shkelin këto ligje. Individët mund ta kritikojnë Qeverinë publikisht ose privatisht. Megjithëse pjesa më e madhe e reklamave Qeveritare u pezulluan në verën e vitit 2015, ka pasur raportime sipas të cilave Qeveria ka tentuar ta pengojë kritikën në media, përmes orientimit të porosive të reklamave drejt medieve pro-qeveritare.

Më 20 korrik, është arritur një marrëveshje në mes të katër partive më të mëdha politike të vendit për të themeluar një Komision Ad-Hoc pesë anëtarësh për monitorimin e zgjedhjeve për të monitoruar harmonizimin me dispozitat e Kodit Zgjedhor për mediat. Në shtator Komisioni ka konstatuar se servisi publik transmetues i Radio Televizioni Maqedonas (RTM) kishte shkelur Kodin Zgjedhor duke transmetuar reklama qeveritare nga 2 shtatori deri më 5 shtator që arriti deri te reklammat politike pa pagesë për partinë në pushtet. Reklammat kanë promovuar programe të ndryshme qeveritare, në fushën e punësimit, arsimit dhe argëtimit. Në përgjigje të konstatimit të Komisionit, Agjencia për Shërbime Audio dhe Audiovizuale ka iniciuar

procedurën për kundërvajtje ndaj RTM-së, duke i kërkuar Gjykatës Administrative të shqiptojë një paralajmërim, dënimi më i ulët në dispozicion.

Në fund të muajit shtator, Komisioni Ad-Hoc ka votuar inicimin e procedurës kundërvajtëse penale kundër televizioneve Sitel dhe TV Nova për raportim të pabalancuar në favor të VMRO-DPMNE-së, duke shkelur kështu Kodin Zgjedhor. Anëtarët e VMRO-DPMNE të Komisionit dhe Asociacioni Maqedonase i Gazetarëve proqeveritar, ka kritikuar vendimin duke pretenduar se metodologjia e përdorur është bazuar në analizë subjektive dhe mund të çojë në censurë.

Liria e mediave dhe shtypit: Individë dhe organizata që duket se kanë qenë të afërta me Qeverinë aktuale kanë pasur në pronë shumicën e mediave kryesore. Sipas raportit të SHGM-së *Përmbledhje e gjendjes me mediat në Maqedoni, të qershorit*, 200 media kanë konkurruar në një treg të vogël dhe të shtrembëruar ku mbijetesa e tyre financiare varet nga aftësia e tyre për të lidhur veten me partitë qeverisëse dhe biznese të mëdha politikisht të lidhura. Një numër i kufizuar i medieve të pavarura kanë qenë aktive dhe kanë shprehur vështrime të ndryshme pa kufizim. Mediet dhe raportimi ka mbetur i ndarë përgjatë linjave etnike dhe politike. Ligjet që ndalojnë gjuhën e cila nxit urrejtjen nacionale, fetare dhe etnike mbulojnë edhe shtypin dhe mediat elektronike, publikimin e librave, si dhe gazetat dhe revistat në internet.

Shumë nga mediat nacionale rrallëherë e kritikojnë Qeverinë. Nga se Qeveria tradicionalisht ka qenë njëra nga blerësit më të mëdhenj të reklamave në shtet, shumë nga mediat kanë mbetur financiarisht të varura nga mjetet e Qeverisë dhe prandaj kanë qenë objekt presioni për të mos e kritikuar të njëjtën. Në Raport progresin për zgjerim të vitit 2015, Komisioni Evropian ka vënë në dukje se reklamat qeveritare kanë qenë burimi më i madh i vetëm i fondeve për mediat dhe ka pasur një ndikim të madh në tregun e mediave në nivel nacional dhe lokal. Ka pasur raporte të besueshme se Qeveria ka shpërdoruar fuqinë e saj në treg në këtë mënyrë. Në verën e vitit 2015, Qeveria ka pezulluar shpenzimet e shtetit për reklamat zyrtare, ndonëse kjo masë nuk i ka përfshirë të gjitha institucionet publike ose institucionet private të lidhur me VMRO-DPMNE. Qeveria nuk ka shpalosur të dhëna relevante për reklamat zyrtare të Qeverisë që nga viti 2014, duke përfshirë edhe mjetet e shpenzuara, përmbajtjen e reklamave, përfituesit e shpenzimeve të reklamave, ose kriteret për dhënien e kontratave reklamuese për transmetuesit.

Sipas Raportit nga muaji qershor i vitit 2015 i Grupit të Ekspertëve të Lartë të Komisionit Evropian, mjedisin mediatic ka privuar gazetaret nga mundësia e tyre për të kryer punën e tyre në mënyrë profesionale dhe pa frikë. Ekspertët mediaticë kanë raportuar se një efekt ftohës ka mbisunduar mjedisin mediatic si: frikësimi, mungesa e kushteve të mira të punës për gazetarët dhe mungesa e qëndrueshmërisë financiare, kompanitë e medias i ka lënë pa mbrojtje nga presioni i Qeverisë dhe në varësi të reklamave të Qeverisë. Ekspertët kanë raportuar për një mjedis të frikës i cili ka nxitur vetë-censurën. Si përgjigje ndaj shqetësimeve serioze mbi raportimin selektiv dhe mungesën e pavarësisë editoriale, nga ana e shërbimit publik transmetues RTM, udhëheqësit e katër partive më të mëdha politike më 20 korrik u pajtuan që partia opozitare LSDM të propozojë kryeredaktorin e shërbimit të lajmeve në Kanalën e parë të RTM-së, TVM 1 që do të mbetet në këtë post deri në fund të ditës së zgjedhjeve, më 11 dhjetor.

Dhuna dhe ngacmimi: Disa gazetarë kanë raportuar se kanë qenë nën presion për ta pranuar raportimin e vështrimeve pro-qeveritare, nën kërcënimin e humbjes së vendit të punës. Disa gazetarë kanë raportuar kërcënime dhe frikësime kundër tyre, duke përfshirë edhe zyrtarë politikë.

Në qershor, Gjykata Administrative ka anuluar vendimin e Komisionit të Lustrimit nga marsi i vitit 2015, me të cilin kryeredaktorja e gazetës së pavarur javore Fokus, Jadranka Kostova, është shpallur bashkëpunëtore e ish-shërbimeve sekrete gjatë viteve 1990, kur ajo ka punuar si gazetare për RTM. Ashtu si edhe në disa raste të tjera, Gjykata Administrative ka konstatuar se Kostovës i është shkelur e drejta për një proces të rregullt para Komisionit, duke mos i dhënë të drejtën për mbrojtje. Me vendimin e Komisionit të Lustrimit asaj i ndalohej kandidimi ose mbajtja e ndonjë posti publik. Kostova ka pretenduar se ka qenë në shënjestër për lustrim në mënyrë selektive si hakmarrje për kritikën e gazetës Fokus kundër Qeverisë.

Santa Argirova, kryeredaktorja e përkohshme e programit të lajmeve në MTV 1 gjatë periudhës parazgjedhore, e propozuar nga opozita, ka raportuar se ka qenë nën presion të vazhdueshëm nga përkrahësit e Qeverisë që kur katër partitë më të mëdha politike kanë rënë dakord për emërimin e saj më 31 gusht. Më 20 shtator, portali pro-qeveritar *Republika* ka emituar

versionin e plotë dhe të paredaktuar të intervistës së realizuar një natë më parë me Prokuroren Speciale Katica Janeva në MTV 1, që dukej se ka për qëllim të paraqesë Janevën në dritë të keqe. *Republika* ka thënë se kasetën e kishte marrë në mënyrë anonime. Bordi i RTM-së ka fajësuar Argirovën për dallimet ndërmjet versionit të redaktuar dhe atij të paredaktuar, duke pretenduar se ajo ka vepruar pa përgatitjen e nevojshme, profesionalizmin, ose lejen nga këshilli për të realizuar dhe për të transmetuar intervistën. Argirova ka deklaruar se me transmetimin e versionit të paredaktuar, *Republika* ka shkelur, etikën profesionale të mediave dhe ka kërcënuar integritetin e medias, ndërkaq ka kërkuar nga shërbimi publik të hetojë incidentin për të siguruar që një situatë e ngjashme mos të ndodhë përsëri.

Në qershor SHGM publikoi një raport, *Rastet e shkeljeve të të drejtave të gazetarëve dhe reagimet e institucioneve në Maqedoni*. Në raport janë konstatuar mbi 30 incidente të veçanta të sjelljes së dhunshme nga përfaqësues të institucioneve publike ndaj gazetarëve. Këto incidente shkonin nga sulme fizike deri te kërcënimet me vdekje, deri te konfiskimi / shkatërrimi i pajisjeve të mediave.

Gjatë vitit, në incidente të shumta përfaqësues të shtypit dhe mediave janë sulmuar apo janë privuar nga mundësia për të raportuar për protestat. Për shembull, më 21 dhe 22 prill, mbështetësit e Lëvizjes pro-qeveritare për Mbrojtjen e Maqedonisë kanë sulmuar një kameraman dhe një gazetar që kanë raportuar drejtpërdrejt nga një protestë kundër Kryetarit të Manastirit, Vlladimir Taleski. Policia ka ndërhyrë për të ndaluar sulmin më 2 prill, por nuk i ka arrestuar ose paditur autorët. Më 17 prill, një grup i protestuesve anti-qeveritar ka bastisur dhe vandalizuar zyrat e Radio Maqedonia e Lirë.

Në Shtip, gazetarja Vanja Micevska nga Kanal 77 ka raportuar se anëtarë të GDOM e kanë ngacmuar dhe kërcënuar kur është përpjekur të mbulojë një nga protestat e saj në maj. Incidentin e ka paraqitur në polici, e cila e ka udhëzuar të largohet nga qyteti, pavarësisht se ua ka treguar kredencialet e saj si gazetare.

Përveç akteve të dhunës dhe ngacmimit, ka pasur njoftime të besueshme se gazetarët kanë hasur në pengesa të tjera gjatë përpjekjeve për të informuar publikun me lajmet e fundit. Për shembull, më 4 prill, kryetari i komunës ka urdhëruar një gazetar nga Berova të largohet nga seanca e Këshillit komunal, prej ku ka raportuar. I njëjti gazetar ka thënë se makina e tij ishte dëmtuar pas largimit të tij nga të seanca.

Censura ose kufizimi i përmbajtjeve: Ka pasur raportime sipas të cilave Qeveria ka detyruar gazetarët të vetë-censurohen. Gazetarët kanë raportuar për ndërhyrje shumë më të madhe gjatë raportimit për çështjet e ndjeshme për Qeverinë. Mediet në pronësi private kanë pohuar që kanë marrë thirrje të rregullta telefonike nga nivelet më të larta qeveritare, për t'i udhëzuar si dhe çka duhet të raportohet për çështjet politike.

Ligjet për shpifje/Siguria nacionale: Personat e shpallur fajtorë për trillime, shpifje dhe gjuhë të ligë janë dënuar sipas gjobave të përcaktuara për shkaktimin e dëmit jomaterial. Disa redaktorë dhe pronarë të medieve e kanë shprehur shqetësimin e tyre se gjobat e larta do të shkaktojnë vetë-censurë. Ka pasur raporte për atë se Qeveria e shfrytëzon ligjin si vegël për goditjen e kundërshtarëve politikë.

Sipas SHGM, deri në tetor, ka pasur rreth 35 raste për shpifje që përfshijnë gazetarët në pritje të gjykimit. Shoqata më parë ka njoftuar se 39 padi për shpifje që përfshijnë gazetarë janë ngritur prej tetorit 2014 deri në tetor 2015. Gjithsej tetë raste të tilla janë gjykuar në vitin 2016, ku gjykata ka hedhur poshtë shtatë raste dhe pjesërisht ka mbështetur pretendimin e paditësit në rastin e tetë. Informacioni në lidhje me rastet në pritje nga vitet e kaluara nuk ishte i plotë.

Në tetor partneri etnik shqiptar i koalicionit, BDI, ka ngritur padi kundër të përditshmes Lajm dhe kryeredaktorit, Isen Salju, "për insinuatat e krimin të kryer nga paditësi, ndërsa partia ka qenë në koalicion me VMRO-DPMNE." Partia ka kërkuar dëmshpërblim prej 25,000 euro (\$ 27,500) për një artikull në faqen e parë më 3 shkurt me titull, "mos u bëni si BDI." Sipas zyrtarëve të partisë, artikulli ka qenë shpifës ndaj partisë. Rasti është ende në pritje të gjykimit në fund të vitit.

Liria e internetit

Qeveria nuk ka kufizuar ose penguar qasjen në internet ose censuruar përmbajtjet në internet. Nuk ka pasur raporte të besueshme për vëzhgim qeveritar të komunikimeve private online pa autorizim përkatës ligjor. Në vazhdim të skandalit me përgjimet në vitin 2015, megjithatë, ka mbizotëruar ndjenjë e gjerë në publik se Qeveria rregullisht e ka ndjekur internetin. Kjo ndjenjë ka bërë që shumë qytetarë të përdorin aplikacionet e mesazheve që ofrojnë kriptim të komunikacionit, siç janë Viber, WhatsApp, Facebook Messenger, dhe Telegram. Enti Shtetëror i Statistikës ka vlerësuar se 69,4 për qind e popullsisë ka përdorur internetin në tremujorin e parë të vitit, në krahasim me 68 për qind në 2014.

Në janar Agjencia e Shërbimeve Audio dhe Audiovizuale ka adoptuar një metodologji për monitorimin e mbulimit të zgjedhjeve në televizion dhe radio, por jo në portalet e internetit, gjë që është kritikuar nga stacionet televizive dhe të radios. Agjencia ka thënë se, përderisa Kodi Zgjedhor i miratuar në nëntor të vitit 2015 e ka vënë atë në krye të monitorimit të portaleve të internetit, Kodi ose ndonjë ligj tjetër askund nuk e ofron përkufizimin e "portalit të internetit" apo përshkrimin e fushëveprimit të portaleve të tilla që janë objekt i monitorimit. Ai gjithashtu ka pohuar se nuk ka asnjë regjistër zyrtar të portaleve të internetit në vend që do t'i mundësojë të identifikojë cilat portale do të jenë subjekt i monitorimit. Në gusht Agjencia përsëri nuk ka pranuar të përfshijë portalet e internetit në metodologjinë e saj të monitorimit, duke përmendur mungesën e vazhdueshme të qartësisë mbi të cilën duhet të monitorohen portalet. Agjencia gjithashtu ka deklaruar se nuk mund të gjejë shembuj të monitorimit të portaleve të internetit nga organe të tjera rregullatore në gjithë Evropën. Disa shoqata të medias, duke përfshirë edhe SHGM, Sindikatën e Pavarur të Gazetarëve dhe Punëtorëve Mediatik, dhe Këshillin e Etikës në Media, kanë shprehur mendimin se rregullimi i portaleve të internetit do të dekurajojë lirinë e shprehjes dhe do ta rris mundësinë e Qeverisë për të ndikuar dhe kontrolluar mediat. Metodologjia përfundimtare e miratuar nga Agjencia në gusht ka hequr monitorimin e portaleve të internetit.

Liria akademike dhe ngjarjet kulturore

Nuk ka pasur kufizime qeveritare për lirinë akademike apo ngjarjet kulturore. Ka pasur incidente, në të cilat anëtarët e VMRO-DPMNE-së kanë ndërhyrë në institucionet e arsimit të lartë për dhe pretendohet kjo të ketë qenë për arsye politike.

Më 30 qershor, anëtarët e parlamentit të studentëve të Universitetit Shën Cirili e Metodi në Shkup, të shoqëruar nga persona të identifikuar si jo-studentë dhe anëtarë të VMRO-DPMNE-së kanë hyrë me forcë në Fakultetin Juridik për të ndërhyrë në zgjedhjen e kryetarit të ri të parlamentit të studentëve. Individët kanë marrë kutitë e votimit dhe janë mbyllur në zyrat e parlamentit të studentëve në kundërshtim me statutin e shoqatës që parasheh votat të numërohen në vendet e votimit. Efektivët policorë të Njësisë për vendosje të shpejtë kanë arritur me autoblanda dhe kanë përdorur forcën për të bllokuar protestuesit nga një organizatë joformale studentore, Plenumi Studentor, dhe për të lejuar që anëtarët e tjerë të parlamentit studentorë të arrijnë me kuti tjera të votimit. Policia ka bllokuar gjatë natës hyrjen në zyrat e parlamentit studentor, kur ka pasur disa konfrontime të tjera të dhunshme, duke përfshirë edhe sulme fizike dhe largime. Herët në mëngjes më 1 korrik, parlamenti studentor ka shpallur fituesin dhe ka pretenduar se në zgjedhje kanë marrë pjesë 5,264 studentë votues, edhe pse vlerësimet për pjesëmarrjen nga monitoruesit nga Plenumi Studentor kanë qenë shumë më të ulëta. Në fillim të korrikut, universiteti ka mbajtur një seancë urgjente dhe ka krijuar komision për të rishqyrtuar zgjedhjet; deri në fund të vitit nuk ka informacion nëse ky komision ka mbajtur takim.

b. Liria e tubimit paqësor dhe shoqërimin

Ligji e parasheh lirinë e tubimit dhe shoqërimin. Ndërsa Qeveria në përgjithësi i ka respektuar këto të drejta, janë raportuar disa raste të ndërhyrjes nga pushteti.

Protestat më të rëndësishme gjatë vitit janë organizuar nga lëvizja aktiviste qytetare #Protestoj pas faljes së diskutueshme nga ana e presidentit Ivanov më 12 prill për 56 individë lidhur me skandalin e përgjimit të paligjshëm. Gjatë këtyre protestave, që më vonë janë quajtur "Revolucioni i larmë", policia ka penguar disa protestues të ushtrojnë të drejtën e tyre për lirinë e tubimit dhe ka pasur disa raste të përlëshjeve midis policisë dhe protestuesve, që

kanë rezultuar me lëndime në të dy anët. Policia ka thirrur në bisedë informative ose ka arrestuar disa prej protestuesve, përfshirë edhe anëtarët e Komitetit të Helsinkit në vend (shih pjesën 1.d.).

b. Liria e tubimit paqësor dhe shoqërimit

Ligji e parasheh lirinë e tubimit dhe shoqërimit ndërsa Qeveria në përgjithësi i ka respektuar këto të drejta.

c. Liria e besimit fetar

Shikoni *Raportin e Departamentit të Shtetit mbi liritë fetare ndërkombëtare* në www.state.gov/j/drl/irf/rpt

d. Liria e lëvizjes, personat e zhvendosur brenda vendit, mbrojtja e refugjatëve dhe personave pa shtetësi.

Ligji parasheh liri të lëvizjes brenda vendit, udhëtim në vendet e jashtme, emigrim dhe riatdhesim. Në përgjithësi, Qeveria i ka respektuar këto të drejta.

Keqtrajtimi i migrantëve, refugjatëve, dhe personave pa shtetësi: Mijëra emigrantë kanë vazhduar të tranzitohen deri më 7 mars, kur autoritetet e kanë mbyllur kufirin jugor të vendit me Greqinë për të ndaluar fluksin e emigrantëve, duke mbyllur kështu "Trajektoren e Ballkanit Perëndimor të emigrantëve." në fund të muajit nëntor, autoritetet kanë kapur dhe kanë kthyer në Greqi, më shumë se 35,000 emigrantë në tentim për të hyrë ilegalisht në vend, ndërsa më shumë se 150 emigrantë dhe refugjatë respektivisht kanë mbetur të bllokuar në pikat veriore dhe jugore kufitare me Serbinë dhe Greqinë.

Gjatë vitit, policia është akuzuar për përdorimin e forcës për t'i kthyer pas emigrantët dhe azilkërkuesit që janë përpjekur të kalonin kufirin e vendit me Greqinë. Sipas raportimeve të OJQ-ve dhe mediave ndërkombëtare, më 10 prill, policia ka përdorur ujë me presion, bomba tymi, gaz lotsjellës dhe plumba gome kundër një grupi prej 500 emigrantëve të mbledhur në kufi me Greqinë, pasi që emigrantë të shumtë ishin përpjekur të kalonin gardhin kufitar që ndan dy vendet, dhe disa individë kishin hedhur me gurrë në drejtim të policisë.

Pretendohet se policia ka kaluar kufirin dhe ka depërtuar në Greqi duke ndjekur grupin e emigrantëve. Sipas organizatës Mjekët pa Kufij, ata kanë trajtuar 300 persona pas përleshjeve, duke përfshirë 10 të cilët kanë raportuar se ishin rrahur nga policia, 40 që u plagosën nga plumbat e gomës, dhe 200 kanë pasur vështirësi në frymëmarrje, si pasojë e gazit lotsjellës. Qeveria ka pranuar se forcat e sigurisë, së bashku me efektivet e policisë të disa vendeve anëtare të BE-së, janë vendosur në kufirin jugor për të ndihmuar rreth krizës me migrantët dhe refugjatët dhe se kanë përdorur gaz lotsjellës për të shpërndarë një turmë të dhunshme prej mbi 3.000 emigrantësh, por kanë mohuar se kishin përdorur masa të tjera të kontrollit të trazirave apo forcë fizike kundër emigrantëve.

Qeveria ka bashkëpunuar me Zyrën e Komisionarit të Lartë të OKB-së për Refugjatët (UNHCR), Organizatën Ndërkombëtare për Migracion, dhe organizata të tjera humanitare për të ofruar mbrojtje dhe ndihmë për personat e zhvendosur brenda vendit, refugjatët, refugjatët e kthyer, azilkërkuesit, migrantët, personat pa shtetësi, dhe persona të tjerë në nevojë.

Udhëtimi jashtë vendit: Kushtetuta lejon lëvizjen e lirë dhe Qeveria mund ta kufizojë vetëm kur është e domosdoshme për të mbrojtur sigurinë kombëtare, hetimet penale, ose shëndetin publik.

Gjatë vitit, Avokati i Popullit dhe Komiteti i Helsinkit kanë pranuar disa ankesa, sidomos nga individë të përkatësisë rome, se autoritetet shtetërore iu kishin mohuar lirinë e lëvizjes vetëm bazuar në profilin e tyre etnik, racor, dhe / ose fetar, edhe pse numri i ankesave ka qenë më i ulët se vitet e mëparshme. Sipas autoriteteve, duke reaguar ndaj kërkesës së BE-së për zvogëlimin e numrit të azilkërkuesve që vijnë në BE nga Maqedonia, Ministria e Brendshme ka

vazhduar të zbatojë strategjinë e menaxhimit kufitar, për të kufizuar daljen e “azilkërkuesve potencialë të rrejshëm”. Kjo strategji ka përfshirë fushatë në medie, sanksione për agjencitë e udhëtimit që u japin shërbime azilkërkuesve potencialë, si dhe përcaktimin e profilit në kalimet kufitare. Në kuadër të këtyre përpjekjeve, prej muajit janar deri në gusht, autoritetet kufitare ua kanë ndaluar daljen disa personave, shumica romë, për të cilët autoritetet kanë dyshuar se do të kërkojnë azil në BE. Më fillim të nëntorit Ministria e Brendshme ka pranuar se para gjykatës ka 41 raste që pretendojnë se ka pasur diskriminim ndaj romëve nga ana e autoriteteve të imigracionit. Më pas ka lëshuar urdhër për autoritetet e emigracionit për të ndaluar praktikën e ndërhyrjes me lirinë e lëvizjes së qytetarëve romë në vendkalimet kufitare.

Personat e zhvendosur brenda vendit (PZhBV)

Qeveria ka raportuar për 183 persona të zhvendosur, që kanë mbetur në këtë pozitë që nga konflikti i brendshëm i vitit 2001. Prej tyre, 27 kanë jetuar në qendra kolektive, kurse 156 kanë qenë të vendosur në familje mikpritëse.

Më 6 gusht, një shi i rrëmbyeshëm i shoqëruar me përmbytje dhe rrëshqitje të tokës kanë marrë jetën e 22 personave dhe kanë detyruar mbi njëqind njerëz të braktisin shtëpitë e tyre në Shkup dhe Tetovë, shumica e të cilëve mbetën të zhvendosur brenda vendit. Nga këto, 35 janë strehuar në një banesë kolektive në Shkup, dhe afërsisht i njëjti numër janë vendosur te të afërmit e tyre. Mediat lokale kanë raportuar pretendime të individëve nga Shkupi dhe Tetova se qeveria nuk ka shpërndarë ndihma në mënyrë të shpejt ose efikase. Disa kanë pretenduar se autoritetet nuk kanë treguar urgjencë në ofrimin e ndihmave në zonat me shumicë shqiptare.

PZhBV-të kanë pranuar ndihmë themelore, kryesisht nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, por kanë pasur mundësi të vogla për punë, për shkak të shkallës së lartë të papunësisë në vend (zyrtarisht, mbi 24% në tremujorin e parë të vitit).

Gjatë vitit, Qeveria ka vazhduar me inkurajimin e PZhBV për kthimin në vendbanimet e tyre, në rajonet të cilat organet i konsiderojnë të sigurta. Disa PZhBV kanë vazhduar me pohimin se Qeveria nuk siguron përkrahje adekuate me të cilat do të mundësohej kthimi i tyre. Romët e zhvendosur brenda vendit janë ballafaquar me sfida të tjera, për shkak të mos-posedimit të dokumenteve të pronës ku kanë banuar më parë.

Mbrojtja e refugjatëve

Qasja ndaj azilit: Ligjet e vendit e parashohin dhënien e azilit ose statusit të refugjatit, ndërkaq Qeveria ka krijuar sistem për dhënien e mbrojtjes për refugjatët. UNHCR ka raportuar se mekanizmi për përcaktimin e statusit të refugjatëve nuk ka siguruar garanci themelore procedurale dhe përcaktim adekuat, siç parashihet me ligj. Qeveria ka vazhduar me refuzimin e aplikacioneve për azil, kryesisht me arsyetimin se aplikuesit e kanë rrezikuar sigurinë nacionale.

Prej 1 janarit deri në fillim të marsit, Ministria e Brendshme ka mbyllur kufijtë tokësorë të vendit për të huajt të cilët nuk posedojnë dokumente valide të regjistrimit të refugjaëve nga Greqia apo që nuk ishin shtetas të Afganistanit, Irakut, apo Sirisë. Në mesnatë më 7 mars, autoritetet në mënyrë efektive kanë mbyllur kufirin për të gjithë ata që nuk kanë poseduar një pasaportë të vlefshme dhe autorizimin ligjor për të hyrë në vend. Më 4 prill qeveria ka miratuar, pa debat, ndryshimet e Ligjit për azil dhe mbrojtje të përkohshme duke siguruar kështu edhe baza ligjore për mbylljen dhe duke e bërë praktikisht të pamundur për cilindo të hyjë në vend nga toka për të kërkuar azil në vend.

Sipas qeverisë, prej në janar deri në nëntor, forcat e sigurisë kanë zbuluar mbi 35,000 persona në përpjekje të kalonin ilegalisht kufirin jugor me Greqinë. Numri i përpjekjeve të hyrjeve të paligjshme në vend ka rënë në fund të gushtit, pasi policia kufitare ka raportuar se mesatarisht brenda një dite ka zbuluar 18 migrantë të parregullt. Në vend se të kryejnë biseda me çdo emigrant për të vlerësuar nëse shprehin pretendime për trafikim me njerëz ose kërkojnë azil, policia kufitare menjëherë i ka kthyer këta individë në Greqi përmes pikës më të afërt kufitare, nganjëherë duke përdorur forcë fizike. Azilkërkuesve nga vendet e tjera me konflikte aktive, si

Libia dhe Jemeni, u është mohuar hyrja, por numri i tyre ka qenë më i vogël. UNHCR ka deklaruar se këto "shtyrje mbrapa" paraqesin shkelje të Konventës së Refugjatëve të vitit 1951, si dhe Protokollin 4 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Qeveria u ka lëshuar dokumente të identifikimit të gjithë refugjatëve të njohur dhe personave tjerë nën mbrojtje subsidiare. Megjithatë, shpesh herë ka ndodhur që autoritetet t'i vonojnë ose të mos ua lëshojnë dokumentet e identifikimit azilkërkuesve të rinj.

Siç parashikohet me ligj, azilkërkuesit janë të pajisur në mënyrë tipike me një vendbanim, shërbime juridike falas, shërbime themelore shëndetësore dhe të sigurimit, mbrojtje sociale, të drejtën për të kërkuar punësim, dhe arsimim. Pasi azilkërkuesit të kenë marrë statusin e refugjatit, ata i kanë të njëjtat të drejta si qytetarët, edhe pse nuk mund të votojnë, të themelojnë parti politike, ose të shërbejnë në ushtri.

Vendi i sigurt i origjinës / transitit: Më 4 prill, Qeveria miratoi një ligj që zgjeroi konceptin e një "vend të sigurt të tretë" që të përfshijë çdo shtet anëtar të BE-së, NATO-s, apo Zonës së Tregtisë së Lirë të Evropës, me çka në mënyrë efektive përjashton çdo hyrje të migrantëve në vend me vijë tokësore nga vendet e tjera me përjashtim të Kosovës dhe Serbisë për të kërkuar azil. Qeveria nuk ka konsultuar UNHCR mbi ndryshimet në ligjin për azil dhe ka injoruar shqetësimin e shprehur nga UNHCR dhe kërkesën e saj për të shtyrë zbatimin e ndryshimeve.

Zgjidhjet e qëndrueshme: Deri në muajin dhjetor, vetëm 68 prej afro 35 000 azilkërkuesve, që kanë transituar vendin janë pranuar si refugjatë. Asnjë person nga konflikti i vitit 1999 në Kosovë nuk është kthyer në Kosovë, ndërsa 102 kanë pritur të kthehen. UNHCR edhe më tej i ka ndihmuar azilkërkuesit nga Kosova të cilët janë refuzuar dhe që u është lejuar të qëndrojnë në vend. Qeveria u ka lëshuar atyre dokumente të përkohshme identifikimi, për tua siguruar qasjen deri te shërbimet. Ministria e Punës dhe Politikës Sociale ka siguruar zgjidhje të integruara dhe të qëndrueshme, me mbështetjen e UNHCR-së për rreth 600 refugjatë që kanë aplikuar për integrim në vend.

Mbrojtja e përkohshme: Qeveria siguron mbrojtjen shtesë për individët të cilët nuk mund të kualifikohen si refugjatë, por nuk e ia ka dhënë atë asnjë personi gjatë nëntë muajve të parë të vitit.

Personat pa shtetësi

Disa banorë të përhershëm ishin ligjërisht pa shtetësi, pavarësisht përmbytjes së një ose më shumë kritereve për shtetësi. Që nga qershori, UNHCR ka raportuar 641 persona në vend nën mandatin e saj mbi pa shtetësi. UNHCR ka punuar me autoritetet për të zgjidhur situatën e 273 personave të këtyre, kryesisht romë, të cilët nuk kanë qenë të regjistruar dhe pa dokumente të identifikimit. Fëmijët e lindur në vend të personave pa shtetësi konsiderohen shtetas dhe kanë të drejtën të regjistrohen dhe të marrin certifikatë.

Seksioni 3. Liria për të marrë pjesë në procesin politik

Ligji iu ofron qytetarëve mundësinë për të zgjedhur qeverinë e tyre në zgjedhje periodike të lira dhe të drejta të mbajtura me votim të fshehtë dhe në bazë të votimit të përgjithshëm dhe të barabartë. Marrëveshja e arritur më 20 korrik nga katër partitë më të mëdha politike në vend - VMRO-DPMNE, LSDM, BDI, dhe PDSH – ka përfshirë dispozita për të përmirësuar procesin zgjedhor me pastrimin e listës zgjedhore, barazimin e terrenit për mediat para zgjedhjeve, dhe krijimin e një qeverie të përkohshme teknike para zgjedhjeve. Ndërsa katër partitë më të mëdha politike kanë vlerësuar se të gjitha dispozitat janë zbatuar, shumë vëzhgues kanë vënë në dukje se ato janë zbatuar me nivele të ndryshme të efikasitetit.

Zgjedhjet dhe pjesëmarrja politike

Zgjedhjet e fundit: Zgjedhjet më të fundit kanë qenë zgjedhjet parlamentare të dhjetorit, të cilat kanë shënuar një rekord pjesëmarrje të lartë dhe janë konstatuar vetëm parregullsi të vogla. Sipas raportit paraprak të OSBE / ODIHR-it, edhe pse Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve ka hasur në vështirësi gjatë përgatitjes për zgjedhjet, dita e zgjedhjeve përgjithësisht është administruar

mirë dhe me rregull. Ndërsa ODIHR ka konstatuar se liritë themelore janë respektuar në përgjithësi, dhe kandidatët kanë qenë në gjendje të zhvillojnë lirshëm fushatën, ka vënë në dukje se zgjedhjet janë zhvilluar "në një mjedis të karakterizuar nga mungesa e besimit publik në institucionet dhe establishmentin politik, dhe pretendime për detyrimin e votuesve." Sipas ODIHR, zgjedhjet nuk kanë arritur të përmbushin disa angazhime të rëndësishme të OSBE-së për një proces zgjedhor demokratik, duke përfshirë frikësimin e votuesve, presion i përhapur mbi punonjësit publikë, blerjen e votave, detyrimin, dhe shpërdorimin e burimeve administrative.

Partitë politike dhe pjesëmarrja politike: Ka disa kufizime në themelimin ose anëtarësimin në partitë politike, të cilat i nënshtrohen ligjeve të njëjta si çdo qytetar i zakonshëm. Gjatë vitit, koalicioni qeverisës ka dominuar dhe ka manipuluar mediat (shih seksionin 2a). Ndërsa anëtarësimi në një parti politike nuk është i detyrueshëm, ka një sistem aktiv patronazhi në vend ku palët japin përfitime dhe avantazhe të veçanta për anëtarët e tyre. Gjatë vitit, ka pasur pretendime të përhapura se anëtarësimi në një parti të koalicionit qeverisës ka ndikuar në vendimin për punësim në shërbimet publike, duke përfshirë edhe mësimdhënësit dhe efektivët e policisë. Gjatë periudhës para fushatës për zgjedhjet e anuluar të parakohshme parlamentare në prill dhe qershor, OJQ-të kanë dhënë shembuj të shumtë të mbivendosjes të aktiviteteve shtetërore dhe atyre partiake, duke përfshirë edhe shpërdorimin e burimeve qeveritare për qëllime elektorale. Për shembull, ish-kryeministri dhe kreu aktual i VMRO-DPMNE-së, Nikolla Gruevski ka promovuar dhe ka paralajmëruar projekte të Qeverisë, pas dorëheqjes nga post i tij në janar, edhe pse ai nuk kishte mbajtur më asnjë post në Qeveri.

Pjesëmarrja e grave dhe minoriteteve: Nuk ka ligj që kufizon pjesëmarrjen e grave dhe prestarëve të minoriteteve në procesin politik, dhe gratë dhe minoritetet kanë marrë pjesë në të. Sipas ligjit, listat e kandidatëve të secilës parti politike duhet të kenë shumëllojshmëri gjinore, dhe jo më shumë se dy të tretat e kandidatëve të listës mund t'i takojë gjinisë së njëjtë. Burrat kanë dominuar vendet udhëheqëse në partitë politike, me përjashtime të LSDM-së dhe BDI-së, me ç'rast në të dyja postin e nënkryetarit të partisë e mbajë gra, ndërsa Partia për Ripërtëritje Demokratike të Maqedonisë kryesohet nga Liljana Popovska.

Shqiptarët dhe pakicat e tjera etnike kanë vazhduar të ankohen për përfaqësimin e pabarabartë në kuadër të qeverisë dhe për praktikën diskriminuese që i përjashton ata nga pjesëmarrja politike, siç është lëshimi selektiv i certifikatave të sigurisë.

Pjesa 4. Korrupsioni dhe mungesa e transparencës në Qeveri

Ligji parasheh ndjekje penale për korrupsionin e zyrtarëve, ndonëse ka pasur raporte se zyrtarët e përfshirë në korrupsion nuk janë ndëshkuar.

OJQ-të kanë theksuar rolin dominues të qeverisë në ekonomi që ka krijuar mundësitë për korrupsion dhe ka dëmtuar marrëdhëniet e biznesit dhe ka ulur rritjen ekonomike. Qeveria ka qenë punëdhënësi më i madh në vend, dhe disa analistë kanë vlerësuar se ajo punëson mbi 180.000 persona, pavarësisht se statistikën zyrtare tregojnë se punësimin në sektorin publik është rreth 128,000. Qeveria ka përdorur pozitën e vet dominuese në tregun e punës për të ndikuar në sektorë të rëndësishëm të ekonomisë. Industria e ndërtimit, e mbështetur fort nga projektet e financuara nga Qeveria ka dominuar rritjen e PBN. Në tetor Banka Botërore ka raportuar se qeveria kishte subvencionuar 89 për qind të të gjitha vendeve të reja të punës në vend dhe 100 për qind të të gjitha vendeve të reja të krijuara nga investitorët e huaj në zonat e tregtisë së lirë.

Ndërhyrja e Qeverisë në biznesin privat ka qenë e përhapur. Edhe pse nuk ka pasur statistika zyrtare apo të dhëna mbi këtë temë, disa nga përmbajtjet e bisedave të përgjuara të paautorizuara të bëra publike në vitin 2015 kanë mbi këtë problemin. Sipas OJQ-ve, regjistrimet kanë treguar se qeveria, drejtpërdrejt dhe tërthorazi, ka kontrolluar një pjesë të konsiderueshme të kompanive të sektorit privat dhe ka thithur me forcë para prej tyre. Në kompensim, kompanitë që kanë bashkëpunuar me Qeverinë në mënyrë rutinore kanë fituar tenderë qeveritarë. Të lehtësuara nga ligjet shpesh të paqarta dhe kontradiktore dhe me ndryshime të shpeshta, organet e inspeksionit kanë vizituar kompanitë jobashkëpunuese dhe iu kanë shqiptuar dënime të rënda.

Përgjimet e vitit 2015 kanë hedhur dritë edhe mbi disa raste ku zyrtarët qeveritarë kanë urdhëruar hakmarrje kundër bizneseve që besohet të jenë mbështetës të partive politike opozitare, duke përfshirë investitorët e huaj. Disa përfaqësues të biznesit janë ankuar se inspektorët shpesh kanë vizituar zyrat me një "gjobë" të paracaktuar. Ka prova të tjera të besueshme se disa biznese janë të detyruar të paguajnë sponsorizim organizatave të ndryshme të kontrolluara nga Qeveria, ndërsa të tjerët të paguajnë "tarifa" të rregullta në mënyrë që të shmangin ngacmimin nga qeveria.

Ka pasur pretendime të besueshme se Qeveria është përpjekur të zvogëlojë konkurrencën në sektorin privat duke i dëbuar firmat dhe kompanitë e pavarura që kanë marrë qëndrime ose janë drejtuar nga individë në kundërshtim me Qeverinë ose duke i dobësuar në atë masë që t'i nënshtrohen marrjes nga kompanitë pro-qeveritare. Një taktikë e zakonshme ka qenë pagesa selektive për bizneset të kontratave të Qeverisë ndërsa kanë vazhduar pagesat për konkurrentët e tyre cilët janë të lidhur me Qeverinë.

Korrupsioni: Në gusht Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar lëshoi raportin e tij dyvjeçar, i cili vuri në dukje se korrupsioni është rritur që nga viti 2014 dhe se prezenca e korrupsionit ka mbetur e lartë në mesin e publikut. Gjatë vitit, 30.5 për qind e 1.000 të anketuarve në një sondazh të kryer nga organizata kanë raportuar se nga ata është kërkuar një dhuratë, deri 4.9 për qind në vitin 2014. Në mënyrë të ngjashme, 29.2 për qind e të anketuarve kanë ofruar / dhënë një dhuratë, deri 7.7 për qind në vitin 2014. Korrupsioni ka ndryshuar edhe përgjatë vijave etnike, me 83.3 për qind e shqiptarëve etnik që kanë thënë se i janë nënshtuar presionit të paguajnë ryshfet dhe 80.5 për qind janë duke paguar ryshfet, krahasuar me 40.6 për qind dhe 35.5 për qind, respektivisht, të të anketuarve maqedonas.

Sipas Barometrit Global vjetor të Korrupsionit të Transparency International i lëshuar në nëntor, 12 për qind e të anketuarve kanë raportuar se është dashur të paguajnë ryshfet për të marrë shërbime publike për të cilat ata kanë pasur të drejtë ligjore. Të gjithë të anketuarit besojnë se njerëzit e fuqishëm, me ndikim, dhe të pasur ushtrojnë ndikim shumë të fortë mbi politikën.

Gjatë gjashtë muajve të parë të vitit, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit ka përmendur dy raste të shpërdorimit të fondeve publike në Prokurorinë Publike Themelore. Në një nga rastet, komisioni ka iniciuar një procedurë për shkarkimin e një zyrtari publik. Komisioni gjithashtu ka marrë dhe kontrolluar 535 deklaratatë të konfliktit të interesave nga zyrtarë publikë dhe ka konstatuar konflikt interesash në 53 raste; zgjidhja e këtyre rasteve nuk ka përfunduar deri në fund të vitit.

Gjatë vitit, Zyra e Prokurorit për Krim të Organizuar dhe Korrupsion ka hetuar 22 të dyshuar për akuza të lidhura me korrupsion, ka ngritur 16 aktakuza, dhe ka fituar 27 aktgjykime. Krimet kanë përfshirë shpërdorim të pozitës dhe autoritetit zyrtar, pastrimin e parave dhe / ose pastrimin e të ardhurave të tjera kriminale, mitmarrje, dhe pranimin e shpërblimit për ndikim të paligjshëm.

Në rastin e saj të profilit më të lartë, Prokuroria e Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit, me mbështetje nga forcat speciale të policisë, më 6 qershor ka arrestuar tetë persona nga Fakulteti i Ekonomisë i Universitetit shtetëror Shën Cirili e Metodi në Shkup nën akuzën për nxitje dhe marrje të ryshfetit nga studentët. Të dyshuarit ishin shtatë profesorë, përfshirë edhe dekanin dhe Kryetarin e zgjedhur së fundmi të Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Maqedonisë, Taki Fiti, dhe një punonjës të stafit logjistik. Më 14 shtator, Gjykata Themelore Shkupi I, me kërkesë të prokurorisë, ka ndaluar katër profesorët nga kryerja e detyrave të tyre akademike në pritje të një vendimi. Më 6 tetor, prokurorët kanë paditur gjashtë nga tetë të dyshuarit, nën akuzën e pranimit dhe dhënies të ryshfetit, marrjen e shpërblimit për ndikim të paligjshëm, dhe shpërdorim të pozitës dhe autoritetit zyrtar. Prokuroria ka hedhur poshtë akuzat kundër dy të dyshuarve, mes tyre edhe Profesor Fiti, për mungesë provash. Gjykimi nuk kishte përfunduar në fund të vitit.

Gjatë vitit, Prokuroria Speciale ka ngritur dy aktakuza përmbledhëse kundër 21 të dyshuarve, ka hapur nëntë hetime formale penale, dhe ka nisur më shumë se 40 hetimet paraprake për sjellje

evidente kriminale në lidhje me ose që dalin nga përmbajtja e komunikimeve të përgjuara në mënyrë të paligjshme gjatë periudhës 2008-15 .

Që nga krijimi i Zyrës së Prokurorisë Speciale në shtator 2015, mediat pro-qeveritare kanë zhvilluar një fushatë të fuqishme dhe të koordinuar për të sulmuar besueshmërinë, integritetin dhe profesionalizmin e saj, dhe kanë favorizuar vendosjen e pengesave administrative në punën e saj, hetimet, dhe ndjekjet penale. Partia VMRO-DPMNE në pushtet në mënyrë të përsëritur ka penguar punën e zyrës dhe ka kritikuar publikisht Prokuroren Speciale Katica Janeva, duke pretenduar se ajo është e paaftë dhe instrument politik i njëanshëm i opozitës. Faljet e Presidentit Ivanov në prill (shih pjesën 1.d.) kanë pezulluar në mënyrë efektive hetimet e Prokurorisë Speciale për dy muaj. Gjyqësori gjithashtu ka luajtur rol për të penguar efektivitetin e Zyrës së Prokurorisë Speciale.

Një nga rastet më specifike të këtij viti lidhur me korrupsionin, për shembull, ka qenë rasti "ryshfeti" kundër liderit të partisë opozitare LSDM-Zoran Zaev, i paraqitur fillimisht nga Prokuroria Publike Themelore në qershor 2015. Zaev, si kryetar i komunës së Strumicës, ishte akuzuar se ka kërkuar 200,000 euro (\$ 220,000) ryshfet nga një biznesmen lokal për të përfunduar privatizimin e pronës shtetërore. Në janar Prokuroria Speciale ka kërkuar juridiksion mbi rastin, por në prill Këshilli prokurorëve publikë ka refuzuar kërkesën, siç kishte bërë me disa kërkesa të tjera (shih seksionin 1.e.). Rasti u hodh poshtë pas faljes që shpalli Presidenti Ivanov më 12 prill ku në listën e 56 individëve ka qenë i përfshirë edhe Zaev, dhe u rifillua pasi u revokuan të gjitha faljet më 6 qershor. Rasti ka mbetur pezull deri në fund të vitit, dhe Zaev ka vazhduar të pohojë se akuzat janë politikisht të motivuara.

Deklarimet financiare: Ligji për anti-korrupsion kërkon që zyrtarët e emëruar dhe të zgjedhur, së bashku me familjet e tyre të afërta, t'i deklarojnë të ardhurat dhe pasurinë, duke paraparë dënime për shkelje të ligjit. Qytetarët kanë pasur mundësi t'i shohin deklaratimet në ueb-faqen e Komisioni Shtetëror Kundër Korrupsionit. Mungesa e regjistrimit të zyrtarëve të zgjedhur dhe të emëruar edhe më tej e ka penguar kontrollin efektiv të pasurisë dhe mbikëqyrjen e konfliktit të interesave.

Më 7 prill, Partia Liberal-Demokratike (PLD) i bëri thirrje ish-kryeministrit Nikolla Gruevski, të deklarojë pasuritë e tij, siç kërkohet me ligj, në Komisionin Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit. PLD gjithashtu i ka bërë thirrje Drejtorisë së të Ardhurave Publike të marrë masa për të përcaktuar pasurinë e Gruevskit, pasi deklarata e tij e pasurisë nuk ka qenë në dispozicion të publikut në faqen e internetit të Komisionit Shtetëror, edhe pse ligji kërkon që të gjithë zyrtarët e zgjedhur të dorëzojnë një deklaratë të pasurisë brenda 30 ditëve nga ndërprerja e funksionit të tyre publik. Gruevski dorëheqjen e deponoi më 14 janar.

Partia VMRO-DPMNE në pushtet është përgjigjur se Gruevski kishte paraqitur deklaratën e tij në Komisionin Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit në shkurt dhe i bëri thirrje Komisionit të paraqesë deklaratën e pasurisë së Gruevskit në mediat. Kryetari i Komisionit Goran Milenkov i ka thënë medias se Gruevski ka dorëzuar deklaratën e tij të pasurisë në kohë dhe ka pohuar se "nuk kishte asgjë interesante në deklaratën e Gruevskit, pasi ajo nuk është shumë e ndryshme nga deklarata e tij 10 vjet më parë," kur u bë Kryeministër.

Mediat e pavarura kanë mbështetur thirrjen e PLD-së dhe e kanë pyetur se pse Milenkov nuk ka shpërndarë kopje të deklaratës së supozuar për pasurinë e Gruevskit. Milenkov u ka thënë gazetarëve se sistemi elektronik i arkivit të Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit është vendosur në mënyrë të tillë që ai t'i fshijë deklaratat e pasurisë të zyrtarëve në momentin kur funksioni i tyre publik përfundon.

Qasja publike ndaj informatave: Ndërkohë që qasja publike ndaj informatave qeveritare sigurohet me ligj, qasja e qytetarëve dhe medieve ndaj të dhënave financiare të Qeverisë dhe kontratave për furnizim publik mbetet e limituar. Qeveria ka adresuar qasjen e publikut deri te informatat e Plan Veprimi për Partneritet për Qeveri të Hapur, të miratuar nga Qeveria në vitin 2014. Një numër i madh i anëtarëve të shoqërisë civile dhe mediave janë ankuar se Qeveria shpesh ka injoruar kërkesat për qasje në informata në bazë të Ligjit për liri të informimit.

Pjesa 5. Qëndrimi qeveritar ndaj hetimeve ndërkombëtare dhe joqeveritare për shkeljet e pretenduara të të drejtave të njeriut

Ka pasur disa grupe vendase dhe ndërkombëtare të të drejtave të njeriut që në përgjithësi kanë vepruar pa kufizime qeveritare dhe që i kanë hetuar dhe publikuar konstatimet e tyre mbi të drejtat e njeriut. Zyrtarët qeveritarë kanë bashkëpunuar duke i dëgjuar këto grupe por shpeshherë nuk kanë reaguuar ndaj vështrimeve të tyre. Ka pasur njoftime se në fund të dhjetorit, organet tatimore kanë nisur inspektime ndaj disa organizatave për të drejtat e njeriut.

Vetëm para zgjedhjeve të 11 dhjetorit, Drejtoria e të Ardhurave Publike ka vënë në shënjestër me revizione sistematike OJQ-të "Ne vendosim", "Meritojmë më mire" dhe "Qytetarët e Maqedonisë" që kanë udhëhequr fushata për të ndihmuar monitorimin dhe sigurimin e zgjedhjeve të lira. Drejtoria e të Ardhurave Publike ka kryer auditime në javët pas zgjedhjeve. Auditimet kanë përkuar me thirrjet e ish-kryeministrit dhe liderit të VMRO-DPMNE-së Nikolla Gruevski për "de-Soroso-izim" e vendit, një aluzion për t'i dhënë fund mbështetjes ndërkombëtare të donatorëve për OJQ-të. Partia opozitare LSDM, më vonë ka bërë të ditur se 42 anëtarë të opozitës që kanë kritikuar haptazi Gruevskin dhe Qeverinë e mëparshme gjithashtu i janë nënshtruar auditimit dhe hetimeve. Kritikët e auditimeve, përfshirë edhe Avokatin e Popullit, i kanë quajtur ato një "gjueti shtrigash" dhe kanë kërkuar që institucionet publike të mos u shërbejnë interesave të partive politike apo të anëtarëve të tyre.

Kombet e Bashkuara ose organet e tjera ndërkombëtare: Qeveria ka punuar me disa organizata nën ombrellën e Kombeve të Bashkuara, duke përfshirë edhe Fondin e Fëmijëve të OKB-së, UNDP, dhe UNHCR, si dhe organizata të tjera ndërkombëtare duke u fokusuar në financat, mbrojtjen shëndetësore, migracionin dhe refugjatët, si dhe çështjet e sigurisë.

Në prill, pas miratimit të amendamenteve të Ligjit për azil dhe mbrojtje të përkohshme nga Parlamenti, UNHCR i ka dërguar Qeverisë një letër duke kërkuar që ajo të tërheqë amendamentet, sepse me atë bëhet shkelje e Konventës së Refugjatëve të vitit 1951 dhe Protokollit të vitit 1967 të kësaj Konvente duke mohuar çdo refugjati që hyjë në vend me mjete të tjera përveç transportit ajror, mundësinë për të aplikuar për azil.

UNHCR, gjithashtu, ka kërkuar një rol më të madh të Qeverisë në përpjekjet e menaxhimit të kufirit për të siguruar se refugjatët që përpiqen të hyjnë në vend do të kontrollohen me kujdes për të konstatuar të drejtën e aplikimit për azil, identifikimin e kushteve të dëmshme mjekësore, si dhe identifikimin e viktimave të mundshme të trafikimit të personave. Në fund të vitit, Qeveria nuk i ishte përgjigjur kërkesave.

Organet qeveritare për të drejtat e njeriut: Avokati i Popullit ka punuar në drejtim të mbrojtjes së qytetarëve nga shkeljet e të drejtave të tyre nga institucionet publike, uljes së diskriminimit ndaj bashkësive pakicë dhe personave me nevoja të posaçme, promovimit të përfaqësimit të barabartë në jetën publike, si dhe trajtimit të të drejtave të fëmijëve. Qeveria nuk ka siguruar burime të mjaftueshme për zyrën e Avokatit të Popullit dhe të njëjtit nuk ia ka deleguar kontrollin mbi buxhetin e tij.

Në gusht Parlamenti ka miratuar një projekt-ligj për ndryshimin e Ligjit për Avokatin e Popullit me qëllim të harmonizimit të ligjit me Parimet e Parisit të Zyrës së Komisionarit të Lartë për Drejtat e Njeriut të OKB-së në lidhje me statusin e institucioneve kombëtare. Nga njëra anë, Qeveria ka siguruar se ndryshimet do t'i promovojnë të drejtat e njeriut, pluralizmin, dhe sundimin e ligjit, si dhe forcimin e mandatit dhe pavarësinë e Avokatit të Popullit, ndërsa nga ana tjetër, opozita reformat i ka përshkruar si kozmetike dhe të pamjaftueshme për të identifikuar dhe ndëshkuar sjelljen e keqe brenda institucioneve shtetërore.

Trupi ndërministror për të drejtat e njeriut, që kryesohet nga zëvendës kryeministri dhe Ministër i Jashtëm Nikolla Poposki, i ka shqyrtuar problemet lidhur me promovimin e të drejtave dhe lirive të njeriut, që rrjedhin nga konventat ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, të miratuara në vend.

Komisioni shtatë-anëtarësh për Mbrojtje nga Diskriminimi ka mandat për shqyrtimin e ankesave për diskriminim, dhënien e rekomandimeve dhe promovimin e zbatimit të ligjit antidiskriminim. Komisioni nuk ka fuqi për ndëshkimin e kundërvajtësve. Ndryshe nga Avokati i Popullit, Komisioni i ka shqyrtuar ankesat nga sektori publik dhe ai privat, ndonëse publiku ka qenë në masë të madhe i painformuar për ekzistimin e Komisionit. Qytetarët që nuk janë të kënaqur nga rezultati i ankesës mund t'u drejtohen gjykatave, të cilat mund ta pranojnë mendimin e shkruar të Komisionit si dëshmi.

Pjesa 6. Diskriminimi, shpërdorimet shoqërore dhe trafikimi me qenie njerëzore

Femrat

Dhunimi dhe dhuna në familje: Dhunimi, përfshirë edhe dhunën bashkëshortore është i kundërligjshëm. Dënimet për dhunim lëvizin prej një deri në 15 vite burg, por ka zbatim të dobët të ligjit. Dhuna në familje është e paligjshme, por ishte një problem i vazhdueshëm dhe i përhapur. Normat kulturore, duke i përfshirë edhe brengat e viktimave për njollosjen e mundshëm që do t'i shkaktohej familjes, e kanë dekurajuar denoncimin e dhunës kundër femrave, si dhe ngritjen e padive penale. Policia dhe zyrtarët gjyqësorë kanë ngurruar ta ndjekin dhunën bashkëshortore dhe dhunën në familje.

Qeveria ka drejtuar shtatë qendra për strehim me kapacitet të kufizuar dhe një që operohet nga OJQ-të për femrat në rrezik, me kapacitet prej 30 femrave. Një OJQ vendase ka operuar me një kontakt-linjë telefonike në maqedonisht dhe shqip, si dhe me dy qendra krize për strehim të përkohshëm të viktimave të dhunës në familje. OJQ-të lokale që e luftojnë dhunën në familje janë mbështetur kryesisht në donacione ndërkombëtare.

Ngacmimi seksual: Ligji e ndalon ngacmimin seksual në vendin e punës dhe jep udhëzime për shqiptimin e dënimit prej tre muaj deri në tre vite burg. Ngacmimi seksual i femrave në vendin e punës ka qenë problem dhe në përgjithësi, viktimat nuk i kanë denoncuar rastet e këtilla për shkak të frikës nga publiciteti dhe humbja e mundshme e vendit të punës (shih pjesën 7.d.)

Të drejtat e reproduksionit: Çiftet dhe individë kanë të drejtë për vendimmarrje të lirë dhe të përgjegjshme për numrin, intervalin dhe kohën e lindjes së fëmijëve, menaxhimin e shëndetit të tyre riprodhues; dhe mundësimin e qasjes në informatat dhe pasjen e mjeteve për ta bërë këtë, pa diskriminim, detyrim dhe dhunë. Femrat e zonave rurale kanë pasur qasje të kufizuar deri te këshillimet sa i përket planifikimit familjar dhe shërbimeve gjinekologjike, meqë ato gjenden në objektet gjinekologjike që kryesisht janë të vendosura në zonat urbane. Në përgjithësi, femrat romë kanë pasur qasje më të vogël deri te këshillimi për planifikim dhe shërbimet gjinekologjike, meqë shumica nuk kanë pasur dokument identifikimi, i nevojshëm për marrjen e shërbimeve qeveritare, përfshirë edhe shërbimet e kujdesit shëndetësor

Diskriminimi: Femrat kanë status të njëjtë juridik si edhe meshkujt në ligjin e familjes, shtetësisë, dhe trashëgimisë dhe në sistemin gjyqësor. Mbështetësit kanë raportuar se numri i femrave që posedojnë pronë dhe biznese është me përfaqësim më të ulët dhe kanë vërejtur diskriminim të caktuar gjinor në industri të caktuara. Femrat romë dhe shqiptare nuk kanë pasur mundësi të barabarta për punësim dhe arsim, për shkak të kufizimeve tradicionale ose fetare për shkollim dhe pjesëmarrje në shoqëri. Në disa bashkësi të shqiptarëve dhe romëve, femrat janë privuar nga e drejta e votës nga ndonjë mashkull i familjes, që e ka udhëzuar votimin ose ka votuar në emër të anëtareve të familjes.

Fëmijët

Regjistrimi i lindjes: Ligji e përcakton shtetësinë në radhë të parë sipas shtetësisë së prindërve. Ai gjithashtu parasheh mundësinë fitimin e shtetësisë për fëmijët e gjetur në territorin e vendit nëse nuk njihen prindërit, përderisa autoritetet nuk zbulojnë që prindërit janë të huaj para moshës 18-vjeçare të fëmijës. Të gjitha lindjet në spitale dhe institucione mjekësore janë regjistruar automatikisht dhe ligji kërkon që të gjithë fëmijët, përfshirë edhe ata që kanë lindur në shtëpi, të regjistrohen në zyrat e ofiqarit brenda 15 ditëve nga dita e lindjes. Disa

familje rome e kanë vonuar regjistrimin e foshnjave të lindura, duke ia vështirësuar atyre qasjen në përfitimet arsimore, mjekësore dhe përfitime tjera në jetë, për shkak të mungesës së dokumenteve të identifikimit.

Keqpërdorimi i fëmijëve: Keqpërdorimi i fëmijëve ka qenë problem në disa rajone. Mbështetësit e mirëqenies së fëmijëve kanë cekur se fëmijët hezitojnë t'i denoncojnë keqpërdorimet, duke u frikësuar nga institucionalizimi i tyre. Qeveria ka operuar me një linjë telefonike për dhunën në familje, përfshirë edhe keqtrajtimin e fëmijëve.

Martesa e detyruar dhe e hershme: Mosha minimale ligjore për martesë është mosha 18-vjeçare. Gjykata mund ta lejojë martesën për personat e moshës 16-18 vjeçare, në qoftë se konstaton se kanë aftësi mendore dhe fizike për martesë. Martesat e detyruara dhe të hershme kanë ndodhur tek bashkësia rome dhe në masë shumë më të vogël në bashkësinë etnike shqiptare. Ka qenë e vështirë të vlerësohet numri i martesave të detyruara dhe të hershme, për shkak se ato regjistrohen rrallëherë. Planet e Qeverisë për përmirësimin e përfshirjes sociale të popullatës rome kanë përfshirë masa masat për parandalimin e martesave në moshë të hershme, sigurimin e shërbimeve të posaçme sociale, këshillimin në shkollor dhe në bashkësi dhe qasjes më të gjerë ndaj shërbimeve bazike shëndetësore.

Eksploatimi seksual i fëmijëve: Ligji ndalon çdo lloj të eksploatimit të fëmijëve për qëllimet e seksit komercial. Dënimet për eksploatimin e fëmijëve për qëllimet e seksit komercial përcaktohen prej 10 deri në 15 vite burg. Ligji e ndalon pornografinë e fëmijëve dhe dënimet për këtë janë prej pesë deri në 15 vite burg. Mosha minimale për marrëdhënie seksuale me pajtim është mosha 16-vjeçare. Prostitucioni fëmijëror është konsideruar si problem nga autoritetet, por nuk i kanë ditur përmasat. Shteti ka pasur regjistër on-line, ku mund të kërkohet sipas emrit dhe adresës së personave të dënuar për trafikim të fëmijëve dhe keqpërdorim seksual të fëmijëve, ku jepen fotografi, evidenca të dënimit, si dhe adresat e banimit të të dënuarve. Kryerësit e veprës mund të kërkojnë të mënjanojnë nga lista 10 vite pas vuajtjes së dënimit, me kusht që të mos e kenë përsëritur veprën.

Fëmijët e zhvendosur: Sipas Ministrisë për Punë dhe Politikë Sociale në shtator ka pasur 96 fëmijë të zhvendosur me prejardhjes të ndryshme etnike. Një raport në muajin tetor nga Zyra e Avokatit të Popullit ka vlerësuar se 236 fëmijë jetonin pa strehë. Këta fëmijë ishin të moshës deri 18 vjeç; ndërsa shumica jetonin në Shkup, ka pasur shumë edhe në Manastir, Kumanovë, Veles, Gostivar, dhe Kërçovë. Me mbështetje ndërkombëtare, Ministria ka drejtuar pesë qendra ditore për fëmijët e rrugës.. Qeveria ka administruar një strehimore transit për fëmijët e rrugës, por efektiviteti i saj për të siguruar shërbime përkatëse sociale ka qenë i kufizuar si rrjedhojë e sipërfaqes së vogël. Sipas Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale, në fillim të vitit ka pasur 78 fëmijë në rrugë.

Autoritetet qeveritare dhe OJQ kanë asistuar 25 fëmijë migrantë të pashoqëruar në kufi deri më 31 korrik. Nuk ka informatë për të mitur migrantë të pashoqëruar në vend në fund të vitit.

Fëmijët e institucionalizuar: Mbështetësit dhe Avokati i Popullit kanë raportuar për mungesë të llogaridhënies lidhur me rastet e moskujdesit dhe keqpërdorimit të fëmijëve në jetimore, strehimore dhe qendrat e paraburgimit. OJQ-të dhe UNICEF kanë qenë aktive në këtë fushë. Më 1 qershor, Zyra e Avokatit të Popullit ka paraqitur raportin e tij lidhur me Burgun e Tetovës për të mitur, duke e përshkruar jetesën dhe kushtet sanitare çnjerëzore në objektin e burgut, praktikat shqetësuese të trajtimit nga gardianët e burgut, si dhe mungesën e kujdesit mjekësor. Sipas Zyrës së Avokatit të Popullit, nevojat fiziologjike dhe sanitare kanë qenë të paplotësuara; nuk ka pasur asnjë mjek të përherëshëm në detyrë; ndërsa hepatiti është përhapur me anë të marrëdhënieve seksuale në mesin e djemve, disa prej të cilëve kanë qenë viktima të abuzimit seksual.

Rrëmbimi ndërkombëtar i fëmijëve: Shteti është palë-nënshkruese e Konventës së Hagës për aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijëve (1980). Për informata konkrete, vizitoni faqen e internetit të Departamentit të Shtetit:http://travel.state.gov/abduction/country/country_3781.html.

Anti-Semitizmi

Bashkësia hebraike ka vlerësuar se në vend kanë jetuar rreth 200-250 çifutë . Ka pasur incidente të herëpashershme anti-semite në portalet e internetit. Në portalin e internetit "Dudinka", gazetari kontrovers Milenko Nedellkovski dy herë ka postuar komente nënçmuese duke ofenduar komunitetin hebraik. Ai ka pretenduar se Ashkenazët kontrollojnë pjesën më të madhe të botës dhe i ka përshkruar ata si "ideologët, financierët dhe organizatorët e Holokaustit," dhe si "krijues të perceptimit se hebrenjtë ishin viktimat më të mëdha të nazistëve."

Trafikimi me qenie njerëzore

Shikoni *Raportin e Departamentit të Shtetit për trafikimin me qenie njerëzore* në

www.state.gov/j/tip/rls/tiprpt/.

Personat me nevoja të posaçme

Ligji e ndalon diskriminimin e personave në bazë të aftësive të kufizuara fizike, shqisore, intelektuale dhe mendore gjatë punësimit, arsimit, transportit ajror dhe të llojeve tjera të transportit, qasjes ndaj shërbimeve shëndetësore dhe shërbimeve tjera shtetërore. Por, Qeveria nuk i ka zbatuar gjithmonë këto dispozita në mënyrë efektive. Ligji u lejon atyre që pretendojnë se janë diskriminuar të parashtrajnë ankesa në Komisionin për Mbrojtje nga Diskriminimi. Komisioni është i vendosur në zyrë pa qasje për personat me nevoja të veçanta.

Mjetet e posaçme qeveritare për nxitjen e punësimit të personave me aftësi të kufizuara rregullohet me ligj të posaçëm. Agjencia e Punësimit e menaxhon fondin, nën mbikëqyrje të Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale. Ky fond ka siguruar grante për rindërtimin e zyrave ose për furnizimin me pajisje të zyrave, për të siguruar kushte të arsyeshme për persona me nevoja të veçanta. Sipas ligjit, personat me aftësi të kufizuara fizike ose mendore duhet të marrin aprovim nga komisioni mjekësor i Qeverisë, për të shërbyer në pozita mbikëqyrëse në sektorin privat dhe atë qeveritar.

Ligji kërkon që ndërtesat e reja të ndërtohen sipas standardeve për qasje të lehtë, ndërsa objektet ekzistuese publike duhej ta mundësojnë qasje për personat me aftësi të kufizuara deri në vitin 2015. OJQ-të kanë raportuar se godinat publike nuk janë në pajtim me ligjin, ndërsa Qeveria ende priste qartësime nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale për kërkesën e mjedisit "që mundëson qasje të plotë". Shumë objekte të reja nuk kanë tualete me qasje të lehtë. Ndonëse të gjithë autobusët e blerë që në vitin 2013 nga Qeveria për Qytetin e Shkupit kanë mundësuar qasje të lehtë, transporti publik, në masë të madhe nuk ofron akses për personat me aftësi të kufizuara në regjionet e tjera, Ministria e Transportit dhe Lidhjeve ka vazhduar projektin disavjeçar për furnizim me vagonë të rinj, si dhe për rinovimin e stacionit të trenit në Shkup dhe në 10 qytete tjera, për t'i harmonizuar me standardet e qasjes së lehtë.

Ministria e Arsimit dhe Shkencës ka bërë përpjekje për të siguruar mbështetje adekuate për t'ua mundësuar vijimin e rregullt të procesit mësimor fëmijëve me aftësi të kufizuara. Janë punësuar edukatorë të posaçëm, të cilët i janë deleguar nëpër shkolla të caktuara ose si edukatorë "të lëvizshëm" në nivel komunal, për t'i mbuluar të gjitha shkollat e komunës, duke i mbështetur mësimdhënësit të cilët kanë fëmijë me aftësi të kufizuara në klasat me mësim të rregullt. Përveç kësaj, autoritetet shkollore kanë instaluar ashensorë në disa shkolla fillore, si dhe teknologji për t'u ndihmuar nxënësve me aftësi të kufizuara, duke i shfrytëzuar kompjuterët në shkollat e zgjedhura fillore dhe të mesme. Pavarësisht përpjekjeve të cekura, një numër i madh i nxënësve me aftësi të kufizuara edhe më tej mësimin e ndjekin në shkollat speciale.

Pakicat kombëtare/racore/etnike

Sipas regjistrimit të vitit 2002, përbërja e popullatës ka qenë: 64.2% maqedonas, 25.2% shqiptarë, 3.9% turq, 2.7% romë, 1.8% serbë, 0.8% boshnjakë dhe 0.5% vlllehë.

Sipas raportit vjetor të Avokatit të Popullit, pakicat etnike, me përjashtim të serbëve dhe vllahëve, kanë pasur përfaqësim më të ulët në shërbimin publik dhe institucionet tjera shtetërore, përfshirë edhe ushtrinë, policinë, agjencitë e zbulimit, si dhe gjykatat, bankën nacionale, doganat dhe ndërmarrjet publike.

Ligji e mundëson arsimin fillor dhe të mesëm në gjuhën maqedonase, shqipe, rome, turke dhe serbe. Numri i nxënësve të pakicave që e kanë vijuar arsimin e mesëm në gjuhën e tyre amtare ka vazhduar të rritet, veçanërisht pas shpalljes së arsimit të mesëm si obligues në vitin 2007, megjithëse Qeveria nuk ka pasur mundësi të sigurojë mësimdhënie të plotë në gjuhën rome, për shkak të mungesës së mësimdhënësve të kualifikuar.

Marrëdhëniet mes bashkësisë etnike maqedonase dhe asaj shqiptare shpeshherë kanë qenë të tensionuara. Disa incidente ndëretnike, kanë shkaktuar protesta, duke i rritur tensionet mes dy bashkësive më të mëdha. Shqiptarët etnikë kanë vazhduar të ankohen për përfaqësimin e pabarabartë në ministritë qeveritare dhe ndërmarrjet publike. Në Akademinë Policore në vend ka vazhduar të shënojë rënie numri i të trajnuarve nga minoritetet që të jetë në pajtim me Kushtetutën. Shqiptarët etnikë janë ankuar se Qeveria ka projektuar procesin e testimit në akademinë padrejtësisht duke mohuar qasjen e shqiptarëve dhe minoriteteve të tjera. Në veçanti, shqiptarët etnikë janë ankuar për paragjykimet kulturore në testet. Përfaqësimi etnik shqiptar brenda administratës civile të Ministrisë së Mbrojtjes ka mbetur i ulët me vetëm 13.5 për qind, dhe 20 për qind në forcat e armatosura. Disa njësi elite të policisë dhe ushtrisë nuk kanë pothuajse asnjë përfaqësues të minoriteteve etnike.

Marrëdhëniet mes bashkësisë etnike maqedonase dhe asaj shqiptare shpeshherë kanë qenë të tensionuara. Disa incidente ndëretnike, kanë shkaktuar protesta, duke i rritur tensionet mes dy bashkësive më të mëdha. Shqiptarët etnikë kanë vazhduar të ankohen për përfaqësimin e pabarabartë në ministritë qeveritare dhe ndërmarrjet publike.

Romët kanë raportuar diskriminim të gjerë shoqëror. OJQ-të dhe ekspertët ndërkombëtarë kanë raportuar se romët shpeshherë janë refuzuar për punësim, ndërsa disa romë janë ankuar për mungesë të qasjes deri te fondet për mirëqenie publike. Fëmijët romë kanë pasur pjesëmarrje më të lartë në shkollat e veçanta "speciale" për nxënësit me aftësi të kufizuara mendore. OJQ-të rome gjithashtu kanë raportuar se në disa raste, pronarët e kanë ndaluar hyrjen e romëve në objektet e tyre. Disa romë nuk kanë pasur letërnjoftime që janë të nevojshme për marrjen e shërbimeve qeveritare si arsimit, mbështetja sociale ose kujdesi shëndetësor, ndonëse BE dhe UNHCR dhe disa OJQ kanë punuar drejt sigurimit të dokumenteve të identitetit për të gjithë romët.

Në vitin 2014 Qeveria e ka financuar realizimin e Strategjisë Nacionale për Romët, në kuadër të përkushtimit për Dekadën e Romëve (tani pjesërisht e rivendosur si Iniciativa për Integrimin e Romëve 2020), duke siguruar ndihmë në arsim, banim, punësim dhe zhvillim të infrastrukturës. Me përjashtim të arsimit, mjetet nuk kanë qenë të mjaftueshme për të dhënë rezultate domethënëse, veçanërisht në fushën e kujdesit shëndetësor. Qeveria gjithashtu ka vazhduar me financimin e qendrave informative të romëve, të cilat i udhëzojnë romët drejt burimeve arsimore, mbrojtjes shëndetësore dhe burimeve të mirëqenies sociale. Rritja e financimit nga OJQ-të dhe Qeveria për eliminimin e pengesave të arsimit, përfshirë edhe transferet e kushtëzuara të të hollave për nxënësit romë, ka rezultuar me rritje të vazhdueshme të numrit të nxënësve që e vijnë në mësimin, veçanërisht në shkollat e mesme.

Turqit etnikë janë ankuar për diskriminim. Brengat e tyre kryesore janë lidhur me përparimin e ngadalshëm të arritjes së përfaqësimit të barabartë në institucionet qeveritare, si dhe nivelin joadekuat të arsimit dhe medieve në gjuhën turke. Gjuha turke është zyrtare në katër komuna rurale.

Aktet e dhunës, diskriminimit, dhe abuzime të tjera në bazë të orientimit seksual dhe identitetit gjinor

Kushtetuta dhe ligji nuk e ndalojnë diskriminimin në bazë të orientimit seksual dhe identitetit gjinor, dhe ligji kundër diskriminimit nuk e vendosë orientimin si bazë e mbrojtur. Vendi e ka

dekriminalizuar homoseksualitetin në vitin 1996 dhe aktet seksuale midis anëtarëve të të njëjtit seks janë të ligjshme.

Komuniteti LGBTI në vend ka mbetur shumë i marginalizuar. Ekziston një klimë e armiqësisë së përgjithshme ndaj komunitetit LGBTI në mediat kryesore, establishmentin politik, dhe shoqërinë, dhe autoritetet nuk kanë arritur të marrin masa për të ndaluar gjuhën e urrejtjes dhe krimet e urrejtjes kundër individëve LGBTI. Aktivistët që mbështesin të drejtat e LGBTI kanë raportuar incidente të shumta të paragjyqimit shoqëror. Gjuha e urrejtjes, sulme fizike dhe dhunë tjetër, dështimi i policisë për të arrestuar autorët e sulmeve, dhe dështimi i Qeverisë të dënojë ose të luftojë diskriminimin ndaj komunitetit LGBTI kanë qenë çështjet kryesore të identifikuar nga OJQ-të të fokusuara në LGBTI gjatë vitit. Sipas një sondazhi të muajit prill i zbatuar nga OJQ Fronti Subverziv, niveli i diskriminimit të përjetuar nga individë të rinj LGBTI ka qenë gati dy herë më i lartë sa diskriminimi i përjetuar nga persona jo-LGBTI.

Sipas Qendrës për Mbështetje të LGBTI, 75 për qind e komunitetit LGBTI nuk i besojnë policisë për të mbrojtur të drejtat e tyre dhe mbi 90 për qind pretendojnë se institucionet shtetërore nuk ofrojnë informacione të mjaftueshme që do të ndihmonin në procesin e vet-mbrojtjes dhe për të kërkuar ndihmë për mbrojtje ligjore të të drejtave të tyre dhe të sigurisë fizike. Gjykatat nuk i konsiderojnë përgjegjës autorët e dhunës dhe fjalorin e urrejtjes, duke i bërë që shumë viktima të heqin dorë nga denoncimi i sulmeve në polici. Sipas Koalicionit të OJQ-ve për të drejtat seksuale dhe shëndetësore të komuniteteve të marginalizuara, Prokuroria Publike në Shkup nuk ka proceduar mbi 90 për qind të rasteve që përfshijnë krime që synojnë anëtarë të komunitetit LGBTI.

Sipas OJQ-ve, ka pasur një mungesë të vullnetit mes partive politike për të trajtuar problemin e dhunës dhe diskriminimit ndaj pjesëtarëve të komunitetit LGBTI. Përfaqësues të Qeverisë zakonisht kanë munguar në diskutimet publike mbi çështjet që kanë të bëjnë me komunitetin LGBTI.

Ka pasur disa përmirësime gjatë vitit në lidhje me përpjekjet e komunitetit LGBTI për të tërhequr vëmendjen ndaj çështjeve LGBTI dhe për të festuar diversitetin. Autoritetet kanë lejuar zhvillimin e ngjarjeve të Javës së Krenarisë dhe tubime të tjera publike në mbështetje të të drejtave të LGBTI, dhe organizatorët raportuan se kanë pasur bashkëpunim më të mirë me autoritetet administrative dhe të sigurisë lokale. Përveç kësaj, më 14 dhjetor, Qendra për Mbështetje të Komunitetit LGBTI ka nënshkruar një Memorandum bashkëpunimi me Zyrën e Avokatit të Popullit për këmbim të informacioneve dhe për të punuar së bashku për të mbrojtur të drejtat e personave LGBTI.

Stigmatizimi shoqëror për HIV dhe AIDS

Ka pasur raporte të izoluara të diskriminimit kundër personave me HIV/AIDS gjatë punësimit dhe qasjes ndaj kujdesit shëndetësor.

Pjesa 7. Të drejtat e punëtorëve

a. Liria e Shoqërimit dhe e drejta për marrëveshje kolektive

Ligji e parasheh të drejtën e themelimit dhe anëtarësimit në sindikata të pavarura, marrëveshje kolektive dhe të drejtën e grevës. Ligji ndalon diskriminimin për aktivitete sindikaliste dhe siguron kthimin në punë të punëtorëve të larguar nga puna për këtë arsye.

Ligji kërkon që sindikatat të regjistrohen në Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale dhe në Regjistrin Qendror të Shtetit. Udhëheqësit e sindikatave janë ankuar për rastet kur ministria e ka zgjatur procesin e regjistrimit për muaj të tërë pa shpjegim.

Një gjykatë e juridiksionit të përgjithshëm mund të ndërpresë aktivitetet sindikale me kërkesë të Regjistrin Qendror ose gjykatës kompetente, kur këto aktivitete konsiderohen të jenë "kundër kushtetutës dhe ligjit." Sindikatat janë të detyruara të ndërpresin veprimtarinë e tyre, kur anëtarësia e tyre bie nën një prag minimal, por ligji nuk e përcakton këtë prag minimal. Nuk

ka kufizime shtetësie për anëtarësimin në sindikata, ndonëse shtetasit e huaj duhet të kenë leje të vlefshme pune dhe të jenë të punësuar nga kompania ose organi qeveritar i përcaktuar në lejen.

Qeveria dhe punëdhënësit nuk kanë respektuar gjithmonë lirinë e shoqërimit, duke përfshirë të drejtën e grevës dhe të Marrëveshjes Kolektive. Punëtorët e kanë ushtruar të drejtën e grevës, por sindikatat kanë pohuar se dispozita "përrjashtuese" e ligjit ka lejuar punëdhënësit të përjashtojnë deri në 2 për qind të udhëheqësve të sindikatave nga negociatat kolektive gjatë grevës. Marrëveshja kolektive lejohet vetëm për sindikatat që përfaqësojnë të paktën 20 për qind të të punësuarve dhe shoqatat e punëdhënësve që përfaqësojnë të paktën 10 për qind të punëdhënësve në nivel në të cilin është lidhur Marrëveshja (kompani, sektori, ose vendi). Mjetet qeveritare të ekzekutimit dhe mjetet juridike kanë qenë të pamjaftueshme. Dënimet për shkelje të ligjit kanë lëvizur nga 100 deri në 7,000 euro (\$ 110 në \$ 7,700); ato nuk kanë mjaftuar për të penguar shkeljet. Procedurat administrative dhe gjyqësore përgjithësisht kanë pësuar vonesa të gjata.

Punëtorët kanë ushtruar të drejtën e grevës. Në pranverë, Sindikata e Administratës Publike dhe Gjyqësore ka hyrë në grevë për shkak të pagave dhe kontributeve të ulëta të punonjësve në krahasim me administratën e Prokurorisë Publike Themelore dhe punonjësve të tjerë në administratë. Sindikata ka raportuar forma të ndryshme të presionit mbi anëtarët e saj nga zyrtarët qeveritarë, kryetarët e gjykatave, si dhe ish-kryetari i Këshillit Gjyqësor. Pavarësisht protestave paraprake dhe një greve të përgjithshme të administratës gjyqësore, Ministri i Drejtësisë ka refuzuar të takohet me përfaqësuesit e sindikatave për të diskutuar kërkesat e grevistëve.

Sindikatat, me përjashtim të disa sindikatave sektoriale, në përgjithësi nuk kanë qenë të pavarura nga ndikimi i zyrtarëve të qeverisë, partive politike, dhe punëdhënësve, veçanërisht ato që kanë pasur lidhje të ngushta me koalicionin qeverisës. Disa udhëheqës të sindikatave janë ankuar se kryetari i dy sindikatave më të mëdha, Konfederata e Sindikatave të Lira të Maqedonisë dhe Federata e Sindikatave të Maqedonisë (FSM), janë ndikuar fuqimisht nga ministri i Punës dhe Politikës Sociale dhe kanë pohuar se rizgjedhja e kryetarit të FSM-së për një mandat të dytë ishte orkestruar drejtpërdrejt nga Dime Spasov, ish-ministër i Punës dhe Politikës Sociale.

b. Ndalimi i punës së detyruar

Kushtetuta dhe ligji i ndalojnë të gjitha format e punës së detyruar, ndërsa Qeveria ka zbatuar në masë të madhe ligjet në fuqi. Ligji parashikon një dënim minimal prej katër vjet burg për punë të detyruar apo për shkatërrimin ose heqjen e dokumentit të identifikimit, pasaportës apo dokumenteve të tjera të udhëtimit. Ka pasur raste në të cilat gratë dhe fëmijët i janë nënshtruar punës së detyruar dhe prostitucionit në restorante, bare, klube nate në disa pjesë të vendit. Disa fëmijë romë kanë qenë të detyruar të lypin, shpesh nga të afërmit (shih pjesën 7.c.).

Gjithashtu shih Raportin e Departamentit për Trafikimin me Qeniet Njerëzore www.state.gov/j/tip/rls/tiprpt/.

c. Ndalimi i punës së fëmijëve dhe moshë minimale për punësim

Moshë minimale për punësim është 15 vjeç, ndonëse fëmijët e moshës 14-vjeçare mund të punojnë si praktikantë ose si pjesë e programit zyrtar edukativ. Ligji e ndalon punësimin e të miturve nën moshën 18-vjeçare në vendet e punës që e dëmtojnë shëndetin e tyre psikik ose psikologjik, si dhe moralin. Ligji gjithashtu e ndalon punën e të miturve gjatë orarit të natës ose punën më të gjatë se tetë orë në ditë ose 40 orë në javë.

Ministria e Punës dhe Politikës Sociale (MPPS) është përgjegjëse për zbatimin e ligjeve që e rregullojnë punësimin e fëmijëve. Policia dhe ministria, përmes qendrave për punë sociale, janë përgjegjëse për zbatimin e ligjeve mbi lypjen e detyruar dhe trafikimin. Ligji parasheh dënim me burg prej të paktën 12 vjet për personat që blejnë, shesin, mbajnë, ose marrin të mitur me qëllim të shfrytëzimit. Nëse zbatohen, këto dënime do të jenë të mjaftueshme për të

parandaluar shkeljet.

Edhe pse puna e fëmijëve nuk është e përhapur në vend, ka pasur raporte se individë në ekonominë joformale kanë përdorur punën e fëmijëve. Shembujt më të zakonshëm kanë qenë përdorimi i fëmijëve për të lypur, pastrimi i xhamave të makinave, dhe shitja e cigareve dhe sendeve të tjera të vogla në tregjet e hapura, rrugët, apo në bare dhe restorante të natës. Ndonëse ekzistojnë ligjet e nevojshme në vend, përpjekjet e Qeverisë për eliminimin e keqpërdorimit të punës së fëmijëve kanë qenë kryesisht të paefektshme. Fëmijët e përfshirë në këto aktivitete kanë qenë kryesisht romë dhe kanë punuar për prindërit e tyre ose familjarët. Zyrtarët shpesh nuk kanë arritur të marrin në përgjegjësi ata që i kanë shfrytëzuar fëmijët, ndërkaq fëmijët romë kanë mbetur të pambrojtur nga shfrytëzimi dhe puna e detyruar.

Ministria e Punës dhe Politikës Sociale ka financuar tre qendra të kujdesit ditor ku është siguruar edukimi, shërbimet mjekësore dhe psikologjike për fëmijët që kërkojnë lëmshë në rrugë. Ministria gjithashtu ka financuar një qendër të kujdesit ditor që drejtohet nga një OJQ në lagjen e Shkupit, Shuto Orizarë. Sipas Qeverisë, deri më 5 shtator, patrullat e lëvizshme kanë larguar fëmijët e rrugës dhe i kanë vendosur në qendrat e kujdesit ditor.

Fëmijët i janë nënshtruar shfrytëzimit seksual për qëllime seksuale, një nga format më të këqija të punës së detyruar të fëmijëve (shih pjesën 6, Fëmijët).

Lexoni edhe *Konstatimet e Departamentit të Punës për format më të këqija të punës së fëmijëve* në www.dol.gov/ilab/reports/child-labor/findings/.

d. Diskriminimi në lidhje me punësimin ose profesionin

Ligjet dhe rregulloret e punës në përgjithësi e ndalojnë diskriminimin në lidhje me racën, gjininë, aftësitë e kufizuara, gjuhën, orientimin seksual, gjendjen shëndetësore, apo statusin shoqëror. Ligji nuk adreson diskriminimin në bazë të virusit HIV apo ndonjë statusi me ndonjë sëmundjes tjetër ngjitëse. Qeveria nuk i ka zbatuar ligjet në mënyrë efektive. Aktivistët civilë janë ankuar se Komisioni Shtetëror për Mbrojtje nga Diskriminimi nuk është duke e bërë punën e tij dhe se shërben thjesht si një qendër punësimi për individët e afërt me partinë në pushtet. Diskriminim në punësim dhe profesion ka pasur në baza gjinore, në bazë të aftësisë së kufizuar dhe në bazë të grupeve të caktuara etnike në ushtri, polici, shërbimet e inteligjencës, gjykata, Bankën Kombëtare, në shërbimin doganor, agjencitë shtetërore dhe kompanitë publike dhe private (shih pjesën 6, Minoritete nacionale/racore/etnike). Pavarësisht nga përpjekjet e Qeverisë dhe ndryshimet ligjore për përfshirjen e detyrueshme në arsimin fillor dhe të mesëm, bashkësia romë vazhdon të jetojë në grupe të veçuara, pa shëndetësi përkatëse dhe pa mbrojtje sociale. Të dhënat nga Zyra Shtetërore e Punësimit tregojnë se për shkak të pjesëmarrjes së ulët në sistemin arsimor, veçanërisht në arsimin e lartë, romët në përgjithësi kanë vështirësi në gjetjen e një punë në ekonominë formale. Pagat e grave ngecin pas atyre të burrave dhe të pakta janë gratë në poste drejtuese. Personat me nevoja të posaçme janë ballafaquar me diskriminim në punësim dhe në qasje në vendin e punës.

d. Kushtet e pranueshme të punës

Rroga minimale nacionale ka qenë në vlerë prej 10.800 denarë në muaj (\$174), me përjashtim të industrisë së tekstilit dhe të lëkurës, ku paga minimale ka qenë 8.080 denarë në muaj (\$140). Sipas statistikës zyrtare, neto-rroga mesatare mujore në shtator ka qenë 22.187 denarë (\$384). Pagat më të ulëta mesatare janë paguar në industrinë e lëkurës, 11,606 denarë (\$ 201), si dhe në prodhimin e veshjeve, 12,432 denarë (\$ 215).

Ligji e parashikon javën e punës prej 40 orëve me periudhë pushimi prej të paktën 24 orëve, pushim të paguar vjetor prej 20-26 ditë pune, si dhe përfitime nga pushimi mjekësor. Punëtorët nuk mund të punojnë ligjërisht më gjatë se 8 orë plotësuese në javë ose 190 orë në vit. Sipas marrëveshjes kolektive midis Qeverisë dhe sindikatave, të punësuarit e sektorit publik dhe privat kanë të drejtë të rrogës për orët plotësuese në nivel prej 135% nga rroga e rregullt. Përveç kësaj, të punësuarit të cilët punojnë më tepër se 150 orë plotësuese në vit kanë të drejtë për shtojcë në nivelin e një rroge mujore. Megjithëse Qeveria ka vendosur standardet e

sigurisë dhe shëndetit në punë për punëdhënësit, këto standarde nuk janë zbatuar në sektorin joformal, të cilat përbënin rreth 22 për qind të ekonomisë.

Ministria e Punës dhe Politikës Sociale ka punësuar 79 inspektorë të punës. Kur ata zbulojnë shkelje, inspektorët e punës kanë të drejtë të ngrenë padi kundërvajtëse kundër punëdhënësit dhe ta mbyllin ndërmarrjen, deri në korrigjimin e shkeljeve. Në rast të përsëritjes së shkeljes, pronari mund të gjobitet. Dënimet kanë qenë të mjaftueshme për t'i parandaluar shkeljet, megjithatë, inspektimet nuk kanë qenë të mjaftueshme për të siguruar pajtueshmërinë. Gjatë vitit, Inspektorati i Punës pranë Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale ka paraqitur padi kundër disa ndërmarrjeve për detyrimin e punëtorëve të punojnë me orar të gjatë pa pushimin e paraparë me ligj, mos-regjistrim të të gjithë të punësuarve sipas ligjit, mospagesën e rrogave, përfitimeve dhe punës jashtë orarit, si dhe për shkurtimin e pushimit të të punësuarve. Shkelje të jashtëzakonshme janë konstatuar sa u përket pagave dhe punës në sektorin e tekstilit, hekurudhave dhe shitjes me pakicë.

Paga minimale, orët e punës, si dhe standardet e sigurisë dhe shëndetit në punë nuk janë zbatuar në mënyrë efektive. Shumë punëdhënës kanë punësuar punëtorë duke vepruar në kundërshtim me ligjin, ndërsa bizneset e vogla të tregtisë shpeshherë kërkojnë që të punësuarit të punojnë edhe përtej kufijve ligjore. Këshilli Kombëtar për Siguri dhe Shëndet nuk ka qenë ende plotësisht funksional. Përderisa punëtorët kanë të drejtë ligjore të largohen nga situatat që e rrezikojnë shëndetin ose sigurinë e tyre pa e rrezikuar punësi

Ka pasur 40 viktima në vendin e punës në vitin 2015. Shumica e aksidenteve kanë ndodhur në sektorët e bujqësisë dhe ndërtimit.

Nuk ka pasur aksidente të rënda industriale në vend.